

VENDIM
Nr. 8, datë 6.2.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Sandër Beci	anëtar,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 22.1.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen nr. 30 (K) 2025 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Herald Jonuzaj, Vangelt Duni dhe avokatja e shtetit, Irma Qosja, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Erjola Shia, Ilirian Rusmali dhe Hemion Braho, me autorizim.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Mimoza Arbi dhe Ervina Domi, me autorizim.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në mungesë.

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, përfaqësuar nga prokurorët Dritan Prençi dhe Dorina Bejko, me autorizim.

OBJEKTI: Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës së krijuar ndërmjet Kryeministrit dhe Këshillit të Ministrave, nga njëra anë, dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nga ana tjetër, lidhur me pezullimin e ushtrimit të detyrës së anëtarit të Këshillit të Ministrave.

Shfuqizimi i vendimeve nr. 118, datë 19.11.2025, dhe nr. 120, datë 22.11.2025, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pjesën që kanë disponuar respektivisht për vendosjen dhe për vazhdimin e zbatimit të masës ndaluese të pezullimit të ushtrimit të detyrës së zëvendëskryeminstres dhe ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë, si një akt që cenon garancinë e imunitetit të anëtarit të Këshillit të Ministrave, parimin e ndarjes së pushteteve dhe kompetencat e organeve, që Kushtetuta ka caktuar si autoritete, që propozojnë, emërojnë dhe miratojnë ministrat në detyrë.

Pezullimi i efekteve të vendimit deri në përfundimin e gjykimit të kësaj kërkesë nga Gjykata Kushtetuese.

Interpretimi i pikës 3 të nenit 103 të Kushtetutës, në kuptimin që: “Anëtari i Këshillit të Ministrave, duke gëzuar imunitetin e deputetit, përfiton nga të gjitha garancitë procedurale, që i njeh jo vetëm Kushtetuta këtij të fundit, por edhe legjislacioni procedural penal”.

BAZA LIGJORE: Nenet 7, 73, 97, 98, 99, 103, pika 3, 131, shkronja “ç” dhe 134, shkronja “b”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27, 54, 55 dhe 56 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit, Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë (*Kryeministri*), që kërkoji pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit të interesuar, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*), që kërkoji pranimin e kërkesës, parashtrimet e Presidentit të Republikës së Shqipërisë (*Presidenti*), që deklaroi se e lë vendimmarrjen në çmimin e Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*); prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që kërkoji rrëzimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), që shprehu mungesën e legjitimitetit të tij si palë në këtë gjykim kushtetues, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 14.11.2025 Prokuroria e Posaçme ka paraqitur në GJKKO-në e Shkallës së Parë kërkesën për caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Ndalimi i daljes jashtë shtetit” dhe masës me karakter ndalues “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”, të parashikuara nga nenet 233 dhe 242 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), për shtetasen Belinda Balluku, me detyrë zëvendëskryeministre dhe ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë, njëkohësisht deputete e Kuvendit, nën hetim për kryerjen e veprës penale “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 258, paragrafi 2 dhe 25 të Kodit Penal (*KP*).

2. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 118, datë 19.11.2025, mes të tjerave, ka vendosur pranimin e kërkesës për caktimin e masave shtrënguese dhe ndaluese.

3. Në datën 21.11.2025 kërkuarisi i është drejtuar Gjykatës, duke kërkuar: i. zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës së krijuar ndërmjet Kryeministrit e Këshillit të Ministrave dhe GJKKO-së së Shkallës së Parë; ii. shfuqizimin e vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë që ka vendosur masën ndaluese të pezullimit të ushtrimit të detyrës së zëvendëskryeminstres dhe ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe pezullimin e këtij vendimi; iii. interpretimin e pikës 3 të nenit 103 të Kushtetutës. Kërkuarisi ka pretenduar se vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë duhet të pezullohet, pasi prek interesa të lartë shtetërore, shoqërore, por edhe të vet individëve, si dhe sjell pasoja të pariparueshme për qeverisjen e vendit, duke krijuar vakum institucional, mosfunksionimin e Këshillit të Ministrave dhe pamundësi për ushtrimin e përgjegjësisë dhe të kompetencave që Kushtetuta e legjislativi në fuqi i njeh ekskluzivisht pushtetit ekzekutiv. Sipas tij, pezullimi i një ministri ose zëvendëskryeministri njëkohësisht pezullon veprimtarinë e pushtetit ekzekutiv në fushën e përgjegjësisë së ministrit dhe të zëvendëskryeministrit në fjalë.

4. Me vendimin nr. 120, datë 22.11.2025, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, pasi ka verifikuar kushtet dhe kriteret e zbatimit të masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues dhe

ndalues ndaj shtetases Belinda Balluku të caktuara me vendimin nr. 118, datë 19.11.2025 të kësaj gjykate, ka vendosur vazhdimin e zbatimit të këtyre masave.

5. Në datën 27.11.2025 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me kërkesë për shtimin e objektit të kërkesës, duke kërkuar: “Shfuqizimin e vendimit nr. 120, datë 22.11.2025 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, për pjesën që ka disponuar për vazhdimin e zbatimit të masës ndaluese të pezullimit të ushtrimit të detyrës së zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, si një akt që cenon garancinë e imunitetit të anëtarit të Këshillit të Ministrave, parimin e ndarjes së pushteteve dhe kompetencat e organeve, që Kushtetuta ka caktuar si autoritete, që propozojnë, emërojnë dhe miratojnë ministrat në detyrë.”.

6. Po në datën 27.11.2025 Prokuroria e Posaçme ka paraqitur një qëndrim paraprak në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, për mospranimin nga Gjykata të kërkesës së Kryeministrit, pasi ky i fundit nuk legjitimohet si subjekt që mund të pretendojë konflikt kompetencash dhe as për vendimet gjyqësore të cilat janë ngushtësisht personale.

7. Në datën 2.12.2025 partia “Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë” ka paraqitur kërkesë për ndërhyrje dytësore, në përmbajtje të së cilës ka pretenduar se kërkuesi, Kryeministri, nuk legjitimohet për t’iu drejtuar Gjykatës, pasi e ka marrë këtë pozicion në kundërshtim me Kushtetutën dhe vendimin nr. 28, datë 30.6.2021, të Gjykatës. Kjo për faktin se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka nxjerrë rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve pa u shqyrtuar ankimimet e subjekteve zgjedhore dhe për sa kohë vendimet e këtij komisioni janë të rreme, Kryeministri dhe zëvendëskryeministrja nuk janë legjitimë dhe nuk kanë tagër t’i drejtohen Gjykatës, për rrjedhojë kërkesa duhet të rrëzohet. Ndërsa në datën 4.12.2025 organizata jofitimprurëse “Lëvizja për Mbrojtjen e të Drejtave Universale” ka paraqitur kërkesë për t’u përfshirë si palë e tretë, duke paraqitur edhe një opinion *amicus curiae* në lidhje me çështjen e paraqitur nga kërkuesi, Kryeministri.

8. Kolegji i Gjykatës në datën 2.12.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit në datën 12.12.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike. Për sa u përket kërkesave të partisë “Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë” dhe organizatës jofitimprurëse “Lëvizja për Mbrojtjen e të Drejtave Universale” për t’u përfshirë si palë ndërhyrëse, Mbledhja e Gjyqtarëve arriti në përfundimin se këto dy subjekte nuk justifikojnë interesin kushtetues, pasi mosmarrëveshja kushtetuese në shqyrtim ka të bëjë me konflikt kompetencash dhe në të marrin pjesë vetëm subjektet që janë në konflikt, në kuptimin që janë pjesë e organeve që ushtrojnë kompetencën kushtetuese për të cilën ka lindur konflikti, për rrjedhojë vendosi mospranimin e kërkesave të tyre.

9. Po kështu, Mbledhja e Gjyqtarëve, bazuar në nenin 39 të Ligjit Organik të Gjykatës dhe nenin 28, pika 2, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese (*Rregullore*), ka identifikuar edhe subjektet e interesuara në këtë gjykim kushtetues, duke përcaktuar si të tilla subjektet kundër të cilave është paraqitur kërkesa ose që kanë interes të drejtpërdrejtë për çështjen që shqyrtohet, organin që ka nxjerrë aktin, si dhe çdo subjekt tjetër pjesëmarrja e të cilit vlerësohet e nevojshme për zhvillimin efektiv të gjykimit kushtetues.

10. Njëkohësisht, Mbledhja e Gjyqtarëve, bazuar në nenin 45 të Ligjit Organik të Gjykatës, ka vendosur edhe pezullimin e zbatimit të vendimeve gjyqësore nr. 118, datë 19.11.2025 dhe nr. 120, datë 22.11.2025 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, për pjesën që kanë disponuar caktimin dhe vazhdimin e masës ndaluese “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik” ndaj shtetases Belinda Balluku, me arsyetimin se ato rrezikojnë të sjellin pasoja që prekin interesat shtetërorë gjatë ushtrimit të kompetencave kushtetuese të pushtetit ekzekutiv në drejtim të përcaktimit të politikave të përgjithshme shtetërore. Sipas parashikimeve të nenit 45

të Ligjit Organik të Gjykatës dhe nenit 27 të Rregullores, masa e pezullimit iu njoftua menjëherë organit përkatës që ka nxjerrë vendimet gjyqësore, si dhe u publikua në Fletoren Zyrtare.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar si vijon:

A. Për juridiksionin e Gjykatës

11.1 Midis Kryeministrit e Këshillit të Ministrave dhe GJKKO-së së Shkallës së Parë ka lindur një mosmarrëveshje kompetence, sipas shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës, pasi pezullimi i zëvendëskryeministres dhe ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë cenon veprimtarinë e Këshillit të Ministrave dhe Kryeministrit, duke ndërhyrë në kompetencat e tyre si organe kushtetuese. Këshillit të Ministrave i është pezulluar veprimtaria në njërën prej fushave të përgjegjësisë së tij shtetërore, fusha e infrastrukturës dhe energjisë. Masa e pezullimit e detyron Kryeministrin të propozojë shkarkimin e ministrit aktual dhe emërimin e një ministri të ri. GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk ka juridiksion për çështjet që kanë të bëjnë me mandatin e ministrit, deputetit ose të funksionarëve të tjerë të lartë kushtetues, pasi ata nuk janë organe administrative të zakonshme, por organe kushtetuese. Edhe ankimi ndaj akteve të shkarkimit nga detyra të tyre, në ato raste kur parashikohet nga Kushtetuta, nuk ushtrohet pranë gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, por në Gjykatë. Për sa kohë Kushtetuta nuk ka parashikuar pezullimin e ministrit në Kushtetutë, ai nuk mund të kryhet. Nëse do të lindte një mosmarrëveshje lidhur me emërimin ose shkarkimin e ministrit, kompetente për gjykimin e kësaj mosmarrëveshjeje do të ishte Gjykata dhe jo gjykatat e zakonshme, të cilat nuk kanë juridiksion për mandatin, por vetëm për veprën penale që dyshohet ose akuzohet se ka kryer individi, i cili ushtron një nga funksionet kushtetuese të përmendura në pikën 2 të nenit 135 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, Gjykata duhet të interpretojë edhe nenin 103 të Kushtetutës.

B. Për legjitimimin e kërkuesit

11.2 Kryeministri është subjekt i pakushtëzuar, në kuptim të nenit 134, pikat 1, shkronja “b” dhe 2, të Kushtetutës dhe neneve 54-56 të Ligjit Organik të Gjykatës. Ai legjitimohet për të kundërshtuar të gjitha aktet ligjore ose nënligjore, me karakter normativ ose individual, dhe të çfarëdo pushteti, të cilat cenojnë kompetencat e tij kushtetuese, veprimtarinë, pozitën juridike kushtetuese të Këshillit të Ministrave, si dhe garancitë që Kushtetuta ka parashikuar për anëtarët e tij. Kërkuesi legjitimohet pasi përfaqëson dhe mbron interesat e Këshillit të Ministrave, jo vetëm ngushtësisht të tij. Kërkesa nuk përbën ankim kushtetues individual dhe kërkuesi nuk ka detyrimin t’u drejtohet shkallëve të tjera të gjyqësorit. Ajo është paraqitur brenda afatit 6-mujor nga çasti i lindjes së konfliktit, të parashikuar nga neni 55 i Ligjit Organik të Gjykatës.

C. Për themelin e pretendimeve

C.1. Vendimet e GJKKO-së së Shkallës së Parë kanë cenuar:

11.3 Parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, të parashikuar në nenin 7 të Kushtetutës, pasi, *së pari*, pezullimi nga detyra i anëtarit të Këshillit të Ministrave nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë përbën ndërhyrje në kompetencat e këtij të fundit si organ kushtetues, sepse pengon në përmbushjen e kompetencave të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, për pjesën që ka të bëjë me vendimmarrjen për atë fushë përgjegjësie shtetërore. Këshilli i Ministrave nuk mund të marrë në shqyrtim dhe as të nxjerrë akte për asnjë nismë në fushën e infrastrukturës dhe energjisë. *Së dyti*, organeve të pushtetit gjyqësor, ku përfshihet edhe GJKKO-ja e Shkallës së Parë, nuk u njihet asnjë kompetencë nga Kushtetuta, për emërimin dhe shkarkimin e ministrave, dhe as për pezullimin e tyre. Kompetenca kushtetuese për të propozuar

përbërjen e Këshillit të Ministrave i atribuohet vetëm një subjekti kushtetues, Kryeministrit, dhe nuk mund të ushtrohet nga asnjë subjekt tjetër, pavarësisht nëse është pjesë e pushtetit ekzekutiv, legjislativ ose gjyqësor. Vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë ndërhyrë edhe në kompetencat e Presidentit për emërimin/shkarkimin dhe të Kuvendit për miratimin ose jo të emërimit/shkarkimit të ministrit. Kryeministri, si organ i kompetencës propozuese, nuk mund t'i propozojë Presidentit një masë pezulluese për një anëtar të Këshillit të Ministrave, duke qenë se kompetenca e tij kushtetuese është e qartë dhe nuk lë vend për interpretim. Ai vetëm mund të propozojë emërimin ose shkarkimin, ndërkohë që “pezullimi” i një anëtarit të Këshillit të Ministrave nuk njihet nga sistemi juridiko-kushtetues i shtetit shqiptar.

11.4 Imunitetin e anëtarit të Këshillit të Ministrave, i cili gëzon imunitetin e deputetit, konkretisht garancitë e parashikuara në nenin 73 të Kushtetutës dhe nenin 242 të KPP-së. Për sa kohë KPP-ja ka ndaluar pezullimin nga detyra të të zgjedhurve sipas ligjit elektorale dhe Kushtetuta e ka barazuar anëtarin e Këshillit të Ministrave me deputetin, rrjedhimisht ai nuk mund të pezullohet nga detyra. Ky ometim ligjor për anëtarin e Këshillit të Ministrave mund të konstatohet nga Gjykata. Po kështu, barazia midis anëtarit të Këshillit të Ministrave dhe deputetit mbështetet në pozitën kushtetuese të tyre, si organet më të larta të pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ. Dhënia e imunitetit për këto kategori shërben si një mjet kushtetues për të siguruar funksionimin normal për kryerjen e detyrës në mënyrë të pacenueshme. Për sa kohë Kushtetuta ka parashikuar mbrojtje edhe për të zgjedhurit vendorë, e njëjta garanci duhet të zbatohet edhe për anëtarin e Këshillit të Ministrave. Ky i fundit emërohet nga Presidenti, por i nënshtrohet miratimit nga Kuvendi, pra zgjidhet nga vetë organi që përfaqëson sovranin.

11.5 *Garancitë kushtetuese*, pasi ndalimi për të vendosur pezullimin e ushtrimit të një detyre a shërbimi publik për deputetin, në fakt nuk është vetëm një garanci ligjore, sepse nuk buron thjesht nga neni 242, pika 2, i KPP-së, por nga neni 73, pika 2, i Kushtetutës. Garancia e këtij neni nuk ka si qëllim në vetvete vetë lirinë e deputetit, por e përdor këtë të fundit si mjet për të arritur një synim tjetër fundor, mbrojtjen e detyrës së tij. Qëllimi i imunitetit, sipas këtij neni, është e drejta e deputetit për ushtrimin e detyrës parlamentare të tij, qëllim i cili realizohet nëpërmjet vendosjes së garancisë procedurale të autorizimit paraprak nga Kuvendi për aktet e pushtetit gjyqësor, që i kufizojnë deputetin lirinë personale, duke ia bërë të pamundur të ushtrojë funksionin e tij kushtetues. Sipas të njëjtit arsyetim, pengimi/ndalimi i ushtrimit të detyrës barazohet me një pezullim *de facto* të deputetit nga detyra. Përderisa Kushtetuta nuk lejon miratimin e ndonjë akti që të sjellë *de facto* pasojën e pezullimit të deputetit (ndalimin e tij për të ushtruar detyrën), pa miratimin paraprak të Kuvendit, ai më pak nuk mund të lejojë miratimin e një akti që ta pezullojë *de jure* deputetin. Deputeti nuk mund të pezullohet nga detyra me akt të pushtetit gjyqësor, madje dhe aktet që sjellin në mënyrë të tërthortë pasojën e pezullimit *de facto* për të ushtruar detyrën, nuk mund të merren pa autorizimin e Kuvendit. Pra, çështja nuk ka të bëjë thjesht me një garanci ligjore, por me një garanci kushtetuese. Për rrjedhojë, as ndaj anëtarit të Këshillit të Ministrave nuk mund të merret masa e pezullimit të ushtrimit të detyrës ose shërbimit publik.

12. Subjekti i interesuar, Kuvendi, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar si vijon:

12.1 Pretendimi për cenimin e *parimit të ndarjes së pushteteve* është i bazuar, sepse ndërhyrja gjyqësore në përbërjen e Këshillit të Ministrave që Kuvendi e ka miratuar, përbën cenim të drejtpërdrejtë të kompetencave kushtetuese. Pezullimi i një ministri krijon një situatë ku pushteti gjyqësor ndërhyrë drejtpërdrejt në funksionalitetin e organit më të lartë ekzekutiv kushtetues, si dhe në aftësinë e tij për të marrë vendime në fushën e përgjegjësisë së ministrit të pezulluar, duke krijuar një pamundësi faktike për ushtrimin e kompetencave kushtetuese të Këshillit të Ministrave. Ndërhyrja e pushtetit gjyqësor nuk mund të justifikohet thjesht me

nevojën për hetim penal, pasi Kushtetuta ka parashikuar garanci të veçanta procedurale për funksionarët e lartë shtetërorë. Vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë krijon një situatë juridike që bie në kundërshtim me kompetencat që Kushtetuta i ka njohur Kuvendit në procesin e formimit dhe funksionimit të Këshillit të Ministrave, pasi krijon një gjendje faktike që është në kundërshtim me vendimin e Kuvendit për dhënien e votëbesimit. Pezullimi krijon një situatë të paparashikuar kushtetuese, që ndikon drejtpërdrejt në marrëdhënien funksionale ndërmjet Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave. Kushtetuta nuk njeh institutin e pezullimit të ministrave, në ndryshim nga funksionarë të tjerë politikë. Gjithashtu, pezullimi krijon një vakancë të përkohshme në funksionimin e Këshillit të Ministrave, organ të cilin Kuvendi e ka miratuar si të plotë dhe funksional, si dhe ndikon drejtpërdrejt në zbatimin e programit qeverisës që Kuvendi ka miratuar. Po kështu, pezullimi krijon një konfuzion juridik në lidhje me statusin e akteve që Presidenti ka nxjerrë për emërimin e ministrit, pasi pezullon aktet kushtetuese pa u ndjekur procedura kushtetuese për revokimin e tyre.

12.2 Pretendimi për *cenimin e imunitetit të ministrit* është i bazuar. Kushtetutëbërësi ka vendosur që ministrat gëzojnë imunitetin e deputetit, pra ai ka synuar të sigurojë mbrojtje e cila nuk kufizohet vetëm në garancitë e shprehura në nenin 73 të Kushtetutës, por përfshin të gjitha garancitë procedurale që sistemi juridik ia njeh deputetit, duke përfshirë edhe ato që rrjedhin nga legjislacioni procedural penal. Për rrjedhojë, ministrat nuk mund të pezullohen nga detyra. Parashikimi kushtetues i nenit 103, pika 3, që barazon imunitetin e anëtarit të Këshillit të Ministrave me deputetin, është parashikuar që në Dispozitat Kryesore Kushtetuese. Pezullimi i ministrit nga detyra do të cenonte veprimtarinë ekzekutive në një fushë të tërë përgjegjësie shtetërore, do të çonte në pengimin e zbatimit të programit qeverisës që populli ka votuar, si dhe do të krijonte një vakum institucional që do të dëmtonte interesin publik. Pezullimi i një ministri nga detyra nga ana e një gjykate nuk prek vetëm individin që ushtron atë detyrë, por vetë Këshillin e Ministrave si organ kolegjal kushtetues. Po kështu, pezullimi përbën shkarkim *de facto*, pasi funksionari nuk ka mundësi të ushtrojë thelbin e funksionit të tij. Neni 242, pika 2, i KPP-së, i interpretuar së bashku me nenin 103, pika 3, të Kushtetutës, çon në përfundimin se ndalimi i pezullimit nga detyra zbatohet edhe për ministrat.

12.3 Vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë për pezullimin e ministrit cenon *parimin e luajlësit kushtetues*, duke krijuar një situatë ku pushteti gjyqësor, në mënyrë të njëanshme dhe pa u mbështetur në asnjë dispozitë kushtetuese, ndërhyr në procesin e formimit dhe funksionimit të Këshillit të Ministrave. Emërimi dhe shkarkimi i ministrave bëhet nëpërmjet bashkëveprimit të organeve kushtetuese dhe asnjë organ tjetër nuk mund të ndërhyjë në këtë proces. Vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë ka anashkaluar garancitë kushtetuese të nenit 103 të Kushtetutës. Gjykatat nuk kanë kompetencë për të vlerësuar përgjegjësinë politike të qeverisë ose të anëtarëve të saj. Neni 242 i KPP-së përcakton shprehimisht se kjo masë nuk zbatohet ndaj personave të zgjedhur sipas ligjit elektoral, çka nënkupton se organet e zgjedhura ose ato që rrjedhin nga vullneti i organeve të zgjedhura gëzojnë një mbrojtje të shtuar dhe procedurat për largimin e tyre janë procedura të veçanta. Edhe pse ministri nuk zgjidhet drejtpërsëdrejti nga populli, pozicioni i tij rrjedh nga besimi që Kuvendi i ka dhënë programit politik të Këshillit të Ministrave. Vendimi i pezullimit krijon një precedent të rrezikshëm që mund të çojë në destabilizimin e pushtetit ekzekutiv nëpërmjet vendimeve gjyqësore. Çdo ndërprerje në ushtrimin e funksioneve ministrore krijon pasoja të drejtpërdrejta për qeverisjen e vendit. Kushtetuta ka parashikuar mekanizma specifikë dhe ekskluzivë për largimin e anëtarëve të Këshillit të Ministrave nga detyrat e tyre, por nuk parashikon mundësinë që gjykatat, qofshin të zakonshme ose të posaçme, të pezullojnë ose shkarkojnë ministrat. Juridiksioni i gjykatave të posaçme nuk nënkupton automatikisht kompetencën për të zbatuar

çdo masë procedurale të parashikuar në KPP. Pezullimi gjithashtu krijon precedent ku pushteti gjyqësor mund të ndryshojë *de facto* qeverinë e zgjedhur dhe të miratuar nga Kuvendi dhe të shkarkojë *de facto* një ministër, veçanërisht kur mungon një afat maksimal i përcaktuar.

13. **Subjekti i interesuar, Presidenti**, në seancën plenare publike, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar si vijon:

13.1 Procedura e emërimit dhe shkarkimit të anëtarëve të Këshillit të Ministrave parashikon pjesëmarrjen e Kryeministrit në cilësinë e organit propozues, të Kuvendit si organ ratifikues dhe të Presidentit për dekretimin e tyre, ndërveprim i cili përbën mekanizmin e kontrollit të balancës midis pushteteve. Ndjekja penale është funksion i drejtpërdrejtë dhe ekskluziv i organeve të drejtësisë dhe nuk ka lidhje me raportet midis pushteteve. Neni 242 i KPP-së parashikon pezullimin e veprimtarisë që lidhet me ushtrimin e detyrës ose shërbimit publik, por nuk është dispozitë specifike për anëtarët e Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, kjo dispozitë nuk përjashton specifikisht këta të fundit nga veprimi i saj, por shprehet vetëm për personat e zgjedhur sipas ligjit elektoral. Nëse masa ndaluese e pezullimit nga ushtrimi i një detyre, e vendosur ndaj anëtarit të Këshillit të Ministrave ose ndaj të gjithë Këshillit të Ministrave, ndikon në funksionimin e lirë të pushtetit ekzekutiv, kjo masë merr përmbajtjen e një instrumenti kontrolli dhe balance midis pushteteve. Një instrument i tillë, i cili nuk është i parashikuar në Kushtetutë, por që kushtëzon funksionimin dhe përbërjen e pushtetit ekzekutiv, nuk mund të konsiderohet kushtetues. Nëse masa ndaluese nuk ndikon në funksionimin e lirë dhe të pakushtëzuar të pushtetit ekzekutiv, atëherë kjo masë nuk del nga konteksti penal dhe nuk shndërrohet në instrument kontrolli dhe balance i pushtetit gjyqësor mbi pushtetin ekzekutiv. Analiza nëse masa ndaluese është apo jo ndërhyrje në tagrat e një pushteti tjetër duhet të sqarohet nga Gjykata dhe Presidenti mbështet çdo vendimmarrje të saj.

14. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

A. Për juridiksionin e Gjykatës

14.1 Çështja objekt gjykimi nuk përbën një marrëdhënie juridike të natyrës kushtetuese që të ketë sjellë pasoja konkrete, të cilat të kenë shkaktuar mosmarrëveshje midis palëve. Masat e sigurimit janë vendime individuale me karakter penal dhe nuk janë akte ose veprime që krijojnë konflikt kompetencash në kuptim të nenit 131 të Kushtetutës. Interesat e përgjithshëm institucionalë të Kryeministrit lidhur me funksionimin e qeverisë nuk përbëjnë cenim të drejtpërdrejtë dhe konkret të një kompetence kushtetuese që mund të justifikojë shqyrtimin kushtetues të vendimeve individuale gjyqësore. Marrja e masës së sigurimit ndaj një funksionari të lartë nuk përbën konflikt kompetencash mes pushteteve, pasi Prokuroria e Posaçme ka ushtruar funksionin penal, duke përmbushur detyrën e saj kushtetuese. Në rastin konkret nuk jemi para ushtrimit të një kompetence që buron drejtpërdrejt nga Kushtetuta, ndërsa gjykata ka ushtruar kompetencën që buron nga ligji procedural penal, pra nuk mund të ekzistojë as konflikti i pretenduar. Pezullimi nga ushtrimi i funksionit nuk përbën kompetencë kushtetuese të Kryeministrit, ndaj nuk mund të konsiderohet e cenuar një kompetencë që nuk ekziston në rendin kushtetues. Gjithashtu, Kushtetuta identifikon natyrën kolegjiale të Këshillit të Ministrave, pasi vendimmarrja nuk ushtrohet nga secili ministër në mënyrë individuale. Edhe vlefshmëria e vendimeve të Këshillit të Ministrave nuk kushtëzohet nga prania ose ushtrimi individual i detyrës nga çdo ministër. Ushtrimi i kompetencave të këtij organi kolegjial nuk mund të bllokohet ose të cenohet nga pezullimi i përkohshëm i një ministri të caktuar. Gjithashtu, nuk konstatohet ekzistenca e rrezikut të ardhjes së ndonjë pasojë të rëndë ose të pariparueshme nga pezullimi. Ndërkohë, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka kompetencë ekskluzive për të vendosur masën e pezullimit nga detyra, bazuar në nenin 242, pika 2, të KPP-

së, pasi vazhdimi i ushtrimit të funksionit nga personi i dyshuar paraqet rrezik konkret për pengimin e hetimit, ndikimin mbi provat ose dëshmitarët.

14.2 Për sa kohë mjetet juridike efektive për kundërshtimin e vendimeve gjyqësore nuk janë shteruar, nuk mund të aktivizohet juridiksioni kushtetues, pasi kjo e kthen Gjykatën në një instancë gjykimi paralele, duke cenuar funksionalitetin e saj. Për më tepër, Gjykata nuk mund të vlerësojë mënyrën e administrimit të provave dhe rrethanat faktike të çështjeve penale. Gjykata ndërhyt vetëm në rrethana përjashtimore dhe nuk vepron si instancë e radhës. Masa e pezullimit të ushtrimit të funksionit duhet të mbetet në fuqi për garantimin e vijimit normal të procesit penal. Referuar nenit 131 të Kushtetutës, vendimet individuale gjyqësore, përfshirë vendimet për masat e sigurimit personal, nuk janë pjesë e juridiksionit kushtetues, por i takojnë juridiksionit të zakonshëm. Kërkesa për interpretimin e nenit 103 të Kushtetutës nuk mund të përdoret për të vënë në diskutim pasojat e një akti individual dhe nuk mund të kërkohej *in abstracto*, për rrjedhojë ajo duhet të rrëzohet.

B. Për legjitimimin e kërkuarit

14.3 Kërkuari nuk legjitimohet për t'iu drejtuar Gjykatës, pasi nuk është subjekt i drejtpërdrejtë i procedimit penal dhe nuk ka provuar një interes personal, aktual dhe kushtetues me pasojat të pariparueshme ose shfaqjen e rrezikut për kryerjen e funksioneve të tij. Masat e sigurimit janë vendosur ndaj personit fizik konkret dhe jo ndaj Këshillit të Ministrave si organ kolegjial, as ndaj funksionit kushtetues në vetvete. Në kushtet kur nuk identifikohet një konflikt aktual midis pushteteve, kërkuari nuk ka legjitimitet procedural dhe material për shqyrtimin e kësaj çështjeje. Interesi i pretenduar ka natyrë institucionale dhe jo juridike kushtetuese. Referuar Ligjit Organik të Gjykatës kërkuari mund të kërkojë kontrollin kushtetues të ligjeve dhe akteve normative dhe jo të vendimeve gjyqësore individuale penale. Kërkuari: i. nuk është subjekt i masës së sigurimit; ii. nuk ka pretenduar cenimin e ndonjë të drejte themelore personale; iii. nuk gëzon legjitimitet kushtetues për të përfaqësuar të drejtat individuale të personit ndaj të cilit është vendosur masa; iv. nuk është bartës i ndonjë të drejte themelore të prekur nga masa.

C. Për themelin e pretendimeve

14.4. Pretendimi për cenimin e *parimit të ndarjes së pushteteve* nuk qëndron, pasi masa e pezullimit ka karakter ligjor-parandalues dhe është vendosur në kuadër të procedimit penal, pa përfshirë Kryeministrin ose Këshillin e Ministrave. Aktivizimi i mekanizmave që prodhojnë efekte të drejtpërdrejta në një proces penal përbën ndërhyrje të paautorizuar në pushtetin gjyqësor. Për rrjedhojë, pezullimi i vendimeve të GJKKO-së së Shkallës së Parë cenon drejtpërdrejtë nenin 145, pika 3, të Kushtetutës, i cili ndalon çdo ndërhyrje në veprimtarinë e gjykatave ose të gjyqtarëve. Kjo ndërhyrje rrezikon të krijojë një precedent të rrezikshëm, ku ekzekutivi mund të ushtrojë ndikim mbi vendimet gjyqësore. Vijimi i ushtrimit të detyrës do të cenonte edhe nenin 11 të Kushtetutës që garanton mbrojtjen e ekonomisë së tregut.

14.5. Pretendimi për *cenimin e imunitetit të anëtarit të Këshillit të Ministrave* është i pabazuar, pasi neni 103, pika 3, i Kushtetutës u jep anëtarëve të Këshillit të Ministrave të drejtën për të gëzuar imunitetin e deputetit, por ky imunitet nuk ka karakter absolut dhe nuk krijon mbrojtje për funksionin ekzekutiv. Mandati i deputetit shpreh marrëdhënie përfaqësuese me elektoratin dhe i nënshtrohet një regjimi kushtetues të posaçëm, ndërsa funksioni i ministrit është pjesë e organizimit të pushtetit ekzekutiv dhe u nënshtrohet rregullave të përgjegjësisë ligjore dhe penale që zbatohen për funksionarët e pushtetit ekzekutiv, pa cenuar mandatin e tij parlamentar. Mandati i deputetit buron drejtpërdrejt nga vullneti i popullit dhe gëzon mbrojtje kushtetuese, ndërsa funksioni i ministrit buron nga një akt emërimi i Këshillit të Ministrave dhe është funksion ekzekutiv-administrativ, i cili buron nga një akt emërimi dhe nuk barazohet me

funksionin e deputetit. Një interpretim i ndryshëm do të cenonte parimin e barazisë përpara ligjit. Neni 103, pika 3, i Kushtetutës kufizohet në përcaktimin e imunitetit vetëm për detyrat përfaqësuese të deputetit. Kushtetuta nuk ka synuar të mbrojë funksionin ekzekutiv nga kontrolli penal, por të sigurojë pavarësinë dhe veprimtarinë e Kuvendit. Barazimi i nenit 242 të KPP-së me nenin 73 të Kushtetutës është i gabuar, pasi imuniteti i deputetit buron vetëm nga Kushtetuta dhe asnjë ligj tjetër nuk mund të japë të njëjtin imunitet. Gjykata nuk mund të ndërhyjë për krijimin e një norme kushtetuese që nuk ekziston.

15. Subjekti i interesuar, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, nuk u paraqit në seancë plenare, ndërsa në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës ka shprehur si vijon:

15.1. GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk legjitimohet si palë në gjykimin kushtetues, pasi kontrolli kushtetues ushtrohet mbi aktin shtetëror/vendimin gjyqësor dhe jo mbi gjykatën si palë kundërshtarë. Gjyqtari disponon me vendim dhe titullari i gjykatës nuk legjitimohet që të shprehet në emër dhe për llogari të gjyqtarit për një çështje konkrete në respektim të parimit të pavarësisë së brendshme të pushtetit gjyqësor. Gjyqtari nuk ka varësi nga askush dhe nuk raporton dhe as jep shpjegime për vendimmarrjet e tij përpara kryetarit të gjykatës ose gjykatave më të larta. Vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga gjykata më e lartë dhe asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë ose bazueshmërinë e tyre për sa kohë nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë, pasi në rast se ndërhyhet nga autoritete të tjera shtetërore cenohet neni 145 i Kushtetutës. Vendimet e caktimit të masës së pezullimit nga detyra janë vendime të ankimueshme në juridiksionin gjyqësor të zakonshëm. Për rrjedhojë, GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk mund të marrë pjesë si palë në gjykimin kushtetues për një çështje penale konkrete e cila është në zhvillim e sipër, pasi një gjë e tillë bie jashtë kompetencës së parashikuar nga dispozitat kushtetuese dhe ligjore.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për juridiksionin e Gjykatës

16. Kërkuesi ka pretenduar se midis tij dhe Këshillit të Ministrave, nga njëra anë, dhe GJKKO-së së Shkallës së Parë, nga ana tjetër, ka lindur një mosmarrëveshje kompetence, sipas shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës, pasi pezullimi i zëvendëskryeminstres dhe ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë cenon veprimtarinë e Këshillit të Ministrave në disa nga fushat e përgjegjësisë së tij, si dhe ndërhyr në kompetencat e Kryeministrit, si organ kushtetues, duke sjellë shkarkimin *de facto* të ministres. Sipas kërkuesit, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka ndërhyrë në diskrecionin që Kushtetuta dhe jurisprudenca e Gjykatës i ka njohur Kryeministrit për të propozuar ministrat dhe në pushtetin ekzekutiv, pasi anëtari i Këshillit të Ministrave gëzon imunitetin e deputetit. Kërkuesi ka pretenduar edhe se GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk ka juridiksion për çështjet që kanë të bëjnë me mandatin e ministrit, deputetit ose të funksionarëve të tjerë të lartë kushtetues, pasi ata nuk janë organe administrative të zakonshme, por organe kushtetuese, për rrjedhojë mandati i tyre përbën çështje të së drejtës kushtetuese. Sipas tij, në rast se do të lejohej pezullimi nga detyra i një funksionari kushtetues, siç është ministri, do të duhej që Kushtetuta ta parashikonte shprehimisht këtë mundësi dhe organin kompetent për të vendosur pezullimin. Për sa kohë nuk ka një parashikim të tillë për ministrin në Kushtetutë, pezullimi i tij nuk mund të kryhet. Për këtë shkak lind nevoja për interpretimin e nenit 103, pika 3, të Kushtetutës, i cili ka parashikuar se anëtarët e Këshillit të Ministrave gëzojnë imunitetin e deputetit.

17. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka mbështetur qëndrimin e kërkuarit, duke parashtruar se ndërhyrja gjyqësore në përbërjen e Këshillit të Ministrave, që Kuvendi e ka miratuar, përbën cenim të drejtpërdrejtë të kompetencave kushtetuese. Pezullimi i një ministri krijon një situatë ku pushteti gjyqësor ndërhyr drejtpërdrejt në funksionalitetin e organit më të lartë ekzekutiv kushtetues, si dhe në aftësinë e tij për të marrë vendime në fushën e përgjegjësisë së ministrit të pezulluar, duke krijuar një pamundësi faktike për ushtrimin e kompetencave kushtetuese të Këshillit të Ministrave. Sipas subjektit të interesuar, vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë krijon një situatë juridike që bie në kundërshtim me kompetencat që Kushtetuta i ka njohur Kuvendit në procesin e formimit dhe funksionimit të Këshillit të Ministrave, pasi krijon një gjendje faktike që është në kundërshtim me vendimin e Kuvendit për dhënien e votëbesimit. Po kështu, sipas Kuvendit, pezullimi krijon një situatë të paparashikuar kushtetuese, që ndikon drejtpërdrejt në marrëdhënien funksionale ndërmjet tij dhe Këshillit të Ministrave.

18. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se çështja objekt gjykimi nuk përbën një marrëdhënie juridike të natyrës kushtetuese që të ketë sjellë pasoja konkrete të cilat kanë shkaktuar mosmarrëveshje midis palëve. Masat e sigurimit janë vendime individuale me karakter penal dhe nuk janë akte ose veprime që krijojnë konflikt kompetencash në kuptim të nenit 131 të Kushtetutës. Sipas këtij subjekti, interesat e përgjithshëm institucionale të Kryeministrit lidhur me funksionimin e qeverisë nuk përbëjnë cenim të drejtpërdrejtë dhe konkret të një kompetence kushtetuese që mund të justifikojë shqyrtimin kushtetues të vendimeve individuale gjyqësore. Po sipas subjektit të interesuar, marrja e masës së sigurimit ndaj një funksionari të lartë nuk përbën konflikt kompetencash mes pushteteve, pasi Prokuroria e Posaçme ka ushtruar funksionin penal duke përmbushur detyrën e saj kushtetuese. Pezullimi nga ushtrimi i funksionit nuk përbën kompetencë kushtetuese të Kryeministrit, pra nuk mund të konsiderohet e cenuar një kompetencë që nuk ekziston në rendin kushtetues. Ndërkohë, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, sipas subjektit të interesuar, ka kompetencë ekskluzive për të vendosur masën e pezullimit nga detyra bazuar në nenin 242, pika 2, të KPP-së, pasi vazhdimi i ushtrimit të funksionit nga personi i dyshuar paraqet rrezik konkret për pengimin e hetimit, ndikimin mbi provat ose dëshmitarët. Sipas tij, kërkesa për interpretimin e nenit 103 të Kushtetutës nuk mund të përdoret për të vënë në diskutim pasojat e një akti individual, për rrjedhojë ajo duhet të rrëzohet.

19. Subjekti tjetër i interesuar, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, ka parashtruar se vendimet e caktimit të masës së pezullimit nga detyra nuk janë përfundimtare, por vendime të ankimueshme në juridiksionin gjyqësor të zakonshëm. Sipas tij, vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga gjykata më e lartë dhe asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë ose bazueshmërinë e tyre për sa kohë nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë, pasi në rast se ndërhyhet nga autoritete të tjera shtetërore cenohet neni 145 i Kushtetutës. Në këtë kuptim, ky subjekt ka parashtruar se nuk legjitimohet si palë në gjykimin kushtetues, pasi kontrolli kushtetues ushtrohet mbi aktin shtetëror/vendimin gjyqësor dhe jo mbi gjykatën si palë kundërshtarë. Sipas tij, gjyqtari disponon me vendim dhe titullari i gjykatës nuk legjitimohet që të shprehet në emër dhe për llogari të gjyqtarit për një çështje konkrete, në respektim të parimit të pavarësisë së brendshme të pushtetit gjyqësor. Gjyqtari nuk ka varësi nga askush dhe nuk raporton e as jep shpjegime për vendimmarrjet e tij përpara kryetarit të gjykatës ose gjykatave më të larta. Për rrjedhojë, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka parashtruar se nuk mund të marrë pjesë si palë në gjykimin kushtetues për një çështje penale konkrete që është në zhvillim e sipër, pasi një gjë e tillë bie jashtë kompetencës së parashikuar nga dispozitat kushtetuese dhe ligjore.

20. Paraprakisht, Gjykata vëren se pretendimi i subjektit të interesuar, GJKKO-së së Shkallës së Parë, për mungesë legjitimitimi si palë në gjykimin kushtetues, nuk është i bazuar në planin procedural. Ndonëse në gjykimin e mosmarrëveshjeve të kompetencës kontrolli kushtetues ushtrohet mbi aktin ose veprimin që pretendohet se ka sjellë lindjen e mosmarrëveshjes, si dhe mbi raportin kushtetues ndërmjet organeve/pushteteve, dhe jo mbi gjykatën si subjekt i konfliktit, kjo nuk përjashton pjesëmarrjen e saj në procesin kushtetues. Përkundrazi, neni 39 i Ligjit Organik të Gjykatës parashikon shprehimisht, ndër pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues, si organin që ka nxjerrë aktin, ashtu edhe subjektet me interes të drejtpërdrejtë për çështjen që shqyrtohet. Për rrjedhojë, gjykata që ka nxjerrë vendimin prej të cilit pretendohet se ka lindur mosmarrëveshja mund të thirret dhe të marrë pjesë në këtë gjykim pa u konsideruar, për këtë shkak, si bartëse materiale e konfliktit. Gjithashtu, një pjesëmarrje e tillë nuk cenon parimin e pavarësisë së brendshme të pushtetit gjyqësor, pasi nuk synon dhe nuk lejon që titullari i gjykatës të zëvendësojë gjyqtarin në arsyetimin për themelin e çështjes konkrete ose të japë shpjegime, në emër të tij, për vendimmarrjen gjyqësore. Ajo shërben vetëm për garantimin e kontradiktoritetit dhe sqarimin e elementeve me natyrë institucionale, veçanërisht për sa u përket kufijve të juridiksionit të asaj gjykate, pozitës së saj institucionale në raport me organet/pushtetet e tjera dhe efekteve procedurale të aktit të kundërshtuar.

21. Duke iu kthyer çështjes së juridiksionit të Gjykatës, në nenin 124 të Kushtetutës parashikohet se ajo (Gjykata) zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të saj. Interpretimi përfundimtar i ligjit themelor të shtetit është ndër funksionet më të rëndësishme të kësaj Gjykate, të cilin ajo e ushtron sa herë që vihet në lëvizje për t'u shprehur për një nga çështjet e parashikuara në nenin 131 të Kushtetutës dhe në normat e tjera kushtetuese. Kontrolli kushtetues, në çdo rast, nuk mund të bëhet pa interpretimin e kuptimit të normave kushtetuese që lidhen me çështjen konkrete në shqyrtim (*shih vendimet nr. 36, datë 4.11.2021; nr. 7, datë 24.2.2016; nr. 29, datë 30.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Po kështu, Gjykata ka vlerësuar se ushtrimi i kompetencës së interpretimit përfundimtar të normës kushtetuese kërkon plotësimin e kushteve si vijon: *së pari*, norma që kërkohet të interpretohet duhet të jetë e paqartë dhe si pasojë e kësaj paqartësie që ajo mbart dhe kuptimit që i është dhënë ka lindur një “problem/mosmarrëveshje kushtetues/e”; *së dyti*, kërkohet të ekzistojë një marrëdhënie e ngushtë ndërmjet normës konkrete kushtetuese dhe fakteve, mosmarrëveshjeve ose çështjeve të përcaktuara konkretisht në një ose disa akte të organit kompetent, si pasojë e zbatimit ose kuptimit të padrejtë të kësaj norme kushtetuese; *së treti*, kërkohet që organet, të cilat zbatojnë normën kushtetuese, të kenë mbajtur qëndrimin e tyre për kuptimin/interpretimin e kësaj norme (*shih vendimet nr. 26, datë 25.5.2021; nr. 59, datë 23.12.2014; nr. 24, datë 9.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar gjithashtu se në rastet e konfliktit të kompetencave është e domosdoshme të ketë një mosmarrëveshje konkrete, pasi zgjidhja e çështjeve të kësaj natyre nuk mund të bëhet me kontroll kushtetues *in abstracto* (*shih vendimet nr. 36, datë 1.6.2015; nr. 4, datë 2.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, një mosmarrëveshje kompetence, që paraqitet për zgjidhje para Gjykatës, duhet të ketë natyrë kushtetuese, në kuptimin që subjektet e përfshira në konflikt të jenë të parashikuara nga Kushtetuta dhe që kompetenca e pretenduar të përcaktohet si e tillë po nga dispozitat kushtetuese. Në këtë mënyrë, gjykimi në Gjykatë përqendrohet, pikësepari, në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës, për sa u takon funksioneve të nivelit kushtetues, duke gjetur dhe cilësuar të papajtueshëm me Kushtetutën shkakun vendimtar që ka sjellë lindjen e mosmarrëveshjes (*shih vendimin nr. 36, datë 1.6.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, konflikti i kompetencave mund të ekzistojë nëse dy organe/pushtete pretendojnë ushtrimin e së

njëjtës kompetencë ose kur asnjëri prej dy organeve/pushteteve nuk merr përsipër ushtrimin e një kompetence (*shih vendimet nr. 12, datë 20.5.2008; nr. 20, datë 4.5.2007; nr. 26, datë 4.12.2006, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Nisur nga standardet e mësipërme kushtetuese, Gjykata çmon të ndalet fillimisht në identifikimin e mosmarrëveshjes kushtetuese që pretendohet se ka lindur midis pushteteve, nëse subjektet e përfshira në konflikt janë të parashikuara nga Kushtetuta dhe nëse atij (kërkuesit) i është cenuar një kompetencë kushtetuese.

25. Gjykata vëren se, bazuar në nenin 100 të Kushtetutës, Këshilli i Ministrave merr vendime me propozim të Kryeministrit ose të ministrit përkatës (pika 1), ndërkohë që aktet e Këshillit të Ministrave janë të vlefshme kur nënshkruhen nga Kryeministri dhe ministri propozues (pika 3). Gjithashtu, sipas nenit 102 të Kushtetutës, Kryeministri është organi që përfaqëson Këshillin e Ministrave dhe kryeson mbledhjet e tij, koncepton dhe paraqet drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe përgjigjet për to, siguron zbatimin e legjislacionit dhe të politikave të miratuara nga Këshilli i Ministrave, bashkërendon dhe kontrollon punën e anëtarëve të Këshillit të Ministrave, si dhe kryen detyra të tjera të parashikuara në Kushtetutë e në ligje (pika 1). Ndërsa Ministri, brenda drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, drejton nën përgjegjësinë e tij veprimtarinë që ka në kompetencë (pika 4). Kryeministri ka, gjithashtu, kompetenca propozuese në emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Ministrave, sipas nenit 98 të Kushtetutës, për të siguruar vazhdimësinë dhe mirëfunksionimin e qeverisë gjatë mandatit qeverisës. Ai ka përgjegjësinë të iniciojë procesin e shkarkimit të ministrit dhe të emërimit të ministrit të ri, duke përzgjedhur e propozuar kandidatin që ai e gjykon të përshtatshëm për të ushtruar funksionin e ministrit në Këshillin e Ministrave.

26. Ndërsa Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën para gjykatave të posaçme të parashikuara në nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, si dhe para Gjykatës së Lartë (neni 148/dh, pika 1, i Kushtetutës). Në kuptim të këtyre kompetencave, Prokuroria e Posaçme paraqet kërkesa në gjykatë, përfshirë edhe ato për caktimin e masave ndaluese të sigurimit referuar nenit 240 të KPP-së. Gjithashtu, bazuar në nenin 135 të Kushtetutës gjykatat e posaçme (ku bën pjesë edhe GJKKO-ja e Shkallës së Parë) gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale, ndër të tjera, kundër anëtarit të Këshillit të Ministrave, zëvendësministrit, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur.

27. Në rastin konkret, Gjykata vëren se në kuadër të një hetimi penal ndaj shtetases Belinda Balluku, me detyrë zëvendëskryeministre dhe ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë, është kërkuar nga Prokuroria e Posaçme, ndër të tjera, vendosja e masës ndaluese të sigurimit personal “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”, të parashikuar nga neni 242 i KPP-së. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka pranuar kërkesën e prokurorisë dhe në referim të nenit 5, pika 2, të Kodit Zgjedhor ka vlerësuar se për sa kohë personat e zgjedhur janë deputetët, kryetarët e bashkive ose anëtarët e këshillit bashkiak, ndaj shtetases Belinda Balluku duhet të caktohet edhe masa me karakter ndalues vetëm për pezullimin nga detyra e zëvendëskryeministres dhe ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë, pasi ajo nuk e pengon që të ushtrojë funksionet e saj si deputete e Kuvendit.

28. Në vijim, Gjykata vlerëson se në rastin konkret mosmarrëveshja kushtetuese e pretenduar midis pushteteve ka të bëjë me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të nenit 103, pika 3, të Kushtetutës në këndvështrim të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Subjektet e përfshira në këtë konflikt – nga njëra anë, Kryeministri dhe Këshilli i Ministrave, si organe kushtetuese të pushtetit ekzekutiv, dhe, nga ana tjetër, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, si organ

kushtetues i pushtetit gjyqësor – janë subjekte të parashikuara nga Kushtetuta dhe ushtruese të kompetencave të përcaktuara prej saj.

29. Nisur nga sa më sipër, Gjykata vëren se, ndonëse Kushtetuta nuk parashikon shprehimisht një kompetencë të Kryeministrit ose të ndonjë organi tjetër për pezullimin nga detyra të një ministri, masa ndaluese e kërkuar nga Prokuroria e Posaçme dhe e vendosur nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, në kuadër të një procedimi penal, për nga natyra dhe efektet e saj konkrete, duket se ka sjellë efekte institucionale, si në ushtrimin e funksioneve kushtetuese të ministrit, ashtu edhe në funksionimin e Këshillit të Ministrave. Për këtë arsye, çështja e paraqitur para Gjykatës nuk lidhet thjesht me pasojat individuale të një mase procedurale penale, por paraqet, të paktën në dukje në këtë fazë të shqyrtimit, një çështje me rëndësi kushtetuese lidhur me kufijtë ndërmjet ushtrimit të funksionit gjyqësor dhe sferës së kompetencave të pushtetit ekzekutiv.

30. Gjykata thekson se fakti që akti, nga i cili pretendohet se ka lindur mosmarrëveshja, është një vendim gjyqësor, i nxjerrë nga një organ i pushtetit gjyqësor në ushtrim të funksioneve të tij kushtetuese e ligjore, nuk përjashton, në vetvete, juridiksionin kushtetues për shqyrtimin e një konflikti kompetencash. Në raste të tilla, kontrolli kushtetues nuk ka për objekt verifikimin e korrektesisë së zbatimit të ligjit të zakonshëm në çështjen konkrete, as rivlerësimin e arsytimit gjyqësor në aspektin e meritës, por vlerësimin nëse, përmes ushtrimit të juridiksionit dhe efekteve të aktit përkatës, është prekur sfera e kompetencave kushtetuese të një pushteti tjetër. Në këtë kuptim, si ankimeshmëria e vendimit gjyqësor në rrugë të zakonshme, ashtu edhe mundësia e mënjanimin të mëvonshëm të pasojave të tij përmes ndërhyrjes së një gjykate më të lartë, nuk janë të mjaftueshme për të përjashtuar juridiksionin kushtetues me evokimin e parimit të subsidiaritetit, për sa kohë që mosmarrëveshja e pretenduar paraqet, të paktën në dukje, elemente të një ndërhyrjeje të mundshme në raportet kushtetuese ndërmjet pushteteve për shkak të efekteve të menjëhershme të atij vendimi.

31. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se çështja e ngritur para saj nuk ka për objekt kontrollin e kushtetutshmërisë së vendimit gjyqësor si akt individual, as shqyrtimin e themelit të masës penale ndaj personit të proceduar, por verifikimin nëse, në rrethanat e rastit konkret, përmes efekteve të menjëhershme të atij akti, paraqitet një situatë e mundshme ndërhyrjeje në sferën e kompetencave kushtetuese të pushtetit ekzekutiv. Në këto kushte, dhe pa paragjykuar themelin e kërkesës, Gjykata vlerëson se paraqitet, të paktën në dukje, një mosmarrëveshje konkrete kompetencash kushtetuese ndërmjet pushtetit ekzekutiv dhe atij gjyqësor, e cila hyn në juridiksionin e saj sipas nenit 131, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës. Ndërkohë, vlerësimi përfundimtar mbi ekzistencën ose jo të cenimit të pretenduar të kompetencës kushtetuese, si edhe përcaktimi i pasojave kushtetuese që mund të rrjedhin prej tij, i përkasin shqyrtimit në themel të çështjes.

B. Për legjitimitimin e kërkuarit

32. Kërkuesi ka pretenduar se legjitimohet për t’iu drejtuar Gjykatës me kërkesën objekt shqyrtimi, pasi është subjekt i pakushtëzuar, në kuptim të nenit 134, pikat 1, shkronja “b” dhe 2, të Kushtetutës dhe neneve 54-56 të Ligjit Organik të Gjykatës. Po kështu, ai ka pretenduar se legjitimohet për të kundërshtuar të gjitha aktet ligjore ose nënligjore me karakter normativ apo individual, dhe të çfarëdo pushteti, të cilat cenojnë kompetencat e tij kushtetuese, veprimtarinë, pozitën juridike kushtetuese të Këshillit të Ministrave, si dhe garancitë që Kushtetuta ka parashikuar për anëtarët e tij. Kërkuesi, Kryeministri, ka pretenduar gjithashtu se legjitimohet, pasi përfaqëson dhe mbron interesat e Këshillit të Ministrave, jo vetëm ngushtësisht të tijat. Kërkesa nuk përbën ankim kushtetues individual dhe sipas tij nuk ka

detyrimin t'u drejtohet shkallëve të tjera të gjyqësorit. Ajo është paraqitur brenda afatit ligjor 6-mujor nga çasti i lindjes së konfliktit, i parashikuar nga neni 55 i Ligjit Organik të Gjykatës.

33. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se kërkuesi nuk legjitimohet për t'iu drejtuar Gjykatës, pasi nuk është subjekt i drejtpërdrejtë i procedimit penal dhe nuk ka provuar një interes personal, aktual dhe kushtetues me pasoja të pariparueshme ose shfaqjen e rrezikut për kryerjen e funksioneve të tij. Sipas tij, masat e sigurimit janë vendosur ndaj personit fizik konkret dhe jo ndaj Këshillit të Ministrave si organ kolegjal, as ndaj funksionit kushtetues në vetvete. Në kushtet kur nuk identifikohet një konflikt aktual midis pushteteve, sipas këtij subjekti, kërkuesi nuk ka legjitimitet procedural dhe material për shqyrtimin e kësaj çështjeje, ndërsa interesi i pretenduar ka natyrë institucionale dhe jo juridike kushtetuese. Referuar Ligjit Organik të Gjykatës, subjekti i interesuar ka prapësuar se, kërkuesi mund të kërkojë kontrollin kushtetues të ligjeve dhe akteve normative dhe jo të vendimeve gjyqësore individuale penale. Sipas tij, kërkuesi: i. nuk është subjekt i masës së sigurimit; ii. nuk ka pretenduar cenimin e ndonjë të drejte themelore personale; iii. nuk gëzon legjitimitet kushtetues për të përfaqësuar të drejtat individuale të personit ndaj të cilit është vendosur masa; iv. nuk është bartës i ndonjë të drejte themelore të prekur nga masa.

34. Bazuar në nenin 131, shkronja “ç”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, kompetencë e cila është detajuar në nenin 54 të Ligjit Organik të Gjykatës, i cili parashikon se kërkesa ngrihet nga subjektet në konflikt ose nga subjektet e cenuara drejtpërdrejt nga konflikti (pika 3) dhe se bazë për fillimin e shqyrtimit të këtyre çështjeve përbën çdo lloj akti me karakter ligjor e nënligjor, veprim ose mosveprim i organeve të pushteteve apo i organeve të qeverisjes vendore që ka çuar në mosmarrëveshje kompetencash midis tyre (pika 4).

35. Për sa i përket legjitimitimit *ratione personae*, Gjykata vlerëson se në kushtet kur ka përcaktuar se midis kërkuesit dhe GJKKO-së së Shkallës së Parë duket se ka lindur një mosmarrëveshje kompetencash, e gjen të pabazuar prapësimin e subjektit të interesuar, pasi kërkuesi është subjekti kushtetues në konflikt dhe mosmarrëveshja ka lidhje të drejtpërdrejtë me ushtrimin e veprimtarisë së tij, pra provon interesin e tij të drejtpërdrejtë (*shih paragrafin 29 të vendimit*).

36. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 55 të Ligjit Organik të Gjykatës, kërkesa për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave paraqitet brenda 6 muajve nga data e lindjes së konfliktit. Gjykata vëren se vendimi gjyqësor, i cili është bërë shkak për lindjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, mban datën 19.11.2025, kurse kërkesa është paraqitur në datën 20.11.2025, pra brenda afatit ligjor 6-mujor, prandaj kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

37. Për sa më lart, në kushtet kur kërkuesi dhe Kuvendi nga njëra anë dhe gjykata nga ana tjetër, i kanë dhënë kuptim të ndryshëm dispozitës kushtetuese, nenit 103, pika 3, të Kushtetutës, ndërsa Presidenti ka pohuar se kjo është një çështje e paqartë që ngelet në vlerësim të Gjykatës, Gjykata çmon se për të zgjidhur konfliktin e kompetencave sipas nenit 131, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës bëhet i nevojshëm interpretimi përfundimtar i dispozitës kushtetuese relevante, nenit 103, pika 3, të Kushtetutës, i cili parashikon se anëtarët e Këshillit të Ministrave gëzojnë imunitetin e deputetit. Kjo do të thotë se për t'i dhënë përgjigje kësaj çështjeje Gjykata do të analizojë fillimisht regjimin e imuniteteve të ministrit në këndvështrim të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, dhe më tej edhe garancitë e tjera procedurale po në këndvështrim të të njëjtit parim.

C. Për themelin e pretendimeve

C.1. Për regjimin e imuniteteve të ministrit në këndvështrim të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve

38. Kërkuesi ka pretenduar se ministri gëzon imunitetin e deputetit sipas përcaktimit të nenit 103, pika 3, të Kushtetutës, konkretisht garancitë e parashikuara në nenin 73 të Kushtetutës dhe nenin 242 të KPP-së, pasi Kushtetuta e ka barazuar anëtarin e Këshillit të Ministrave me deputetin. Sipas tij, barazia midis anëtarit të Këshillit të Ministrave dhe deputetit mbështetet në pozitën kushtetuese të tyre, si organet më të larta të pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ. Garancia e këtij neni nuk ka si qëllim në vetvete vetë lirinë e deputetit, por e përdor këtë të fundit si mjet për të arritur një synim tjetër fundor, mbrojtjen e detyrës së deputetit. Sipas kërkuesit, dhënia e imunitetit për këto kategori shërben si një mjet kushtetues për të siguruar funksionimin normal për kryerjen e detyrës në mënyrë të pacenueshme. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar se për sa kohë Kushtetuta ka parashikuar mbrojtje edhe për të zgjedhurit vendorë, e njëjta garanci duhet të zbatohet edhe për anëtarin e Këshillit të Ministrave, i cili emërohet nga Presidenti, por i nënshtrohet miratimit nga Kuvendi, pra zgjidhet nga vetë organi që përfaqëson sovranin.

39. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se kushtetutëbërësi ka vendosur që ministrat gëzojnë imunitetin e deputetit, pra ai ka synuar të sigurojë mbrojtje, e cila nuk kufizohet vetëm në garancitë e shprehura në nenin 73 të Kushtetutës, por përfshin të gjitha garancitë procedurale që sistemi juridik ia njeh deputetit, duke përfshirë edhe ato që rrjedhin nga legjislacioni procedural penal. Sipas tij, neni 242, pika 2, i KPP-së, i interpretuar së bashku me nenin 103, pika 3, të Kushtetutës, çon në përfundimin se ndalimi i pezullimit nga detyra zbatohet edhe për ministrat. Kështu, sipas Kuvendit, vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë ka anashkaluar garancitë kushtetuese të nenit 103 të Kushtetutës, pasi gjykatat nuk kanë kompetencë për të vlerësuar përgjegjësinë politike të qeverisë ose të anëtarëve të saj. Po sipas subjektit të interesuar, neni 242 i KPP-së përcakton shprehimisht se kjo masë nuk zbatohet ndaj personave të zgjedhur sipas ligjit elektoral, çka nënkupton se organet e zgjedhura ose ato që rrjedhin nga vullneti i organeve të zgjedhura gëzojnë një mbrojtje të shtuar dhe procedurat për largimin e tyre janë procedura të veçanta. Edhe pse ministri nuk zgjidhet drejtpërsëdrejti nga populli, pozicioni i tij rrjedh nga besimi që Kuvendi i ka dhënë programit politik të Këshillit të Ministrave.

40. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se neni 103, pika 3, i Kushtetutës u jep anëtarëve të Këshillit të Ministrave të drejtën për të gëzuar imunitetin e deputetit, por ky imunitet nuk ka karakter absolut dhe nuk krijon mbrojtje për funksionin ekzekutiv. Sipas tij, mandati i deputetit shpreh marrëdhënie përfaqësuese me elektoratin dhe i nënshtrohet një regjimi kushtetues të posaçëm, ndërsa funksioni i ministrit është pjesë e organizimit të pushtetit ekzekutiv dhe u nënshtrohet rregullave të përgjegjësisë ligjore dhe penale që zbatohen për funksionarët e pushtetit ekzekutiv, pa cenuar mandatin e tij parlamentar. Prokuroria e Posaçme ka parashtruar gjithashtu se mandati i deputetit buron drejtpërdrejt nga vullneti i popullit dhe gëzon mbrojtje kushtetuese, ndërsa funksioni i ministrit buron nga një akt emërimi i Këshillit të Ministrave dhe është funksion ekzekutiv-administrativ, i cili buron nga një akt emërimi dhe nuk barazohet me funksionin e deputetit. Kushtetuta nuk ka synuar të mbrojë funksionin ekzekutiv nga kontrolli penal, por të sigurojë pavarësinë dhe veprimtarinë e Kuvendit.

41. Subjekti i interesuar, Presidenti, ka parashtruar se ndjekja penale është funksion i drejtpërdrejtë dhe ekskluziv i organeve të drejtësisë dhe nuk ka lidhje me raportet midis pushteteve. Sipas tij, neni 242 i KPP-së parashikon pezullimin e veprimtarisë që lidhet me ushtrimin e detyrës ose shërbimit publik, por nuk është dispozitë specifike për anëtarët e Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, ajo nuk përjashton specifikisht këta të fundit nga veprimi i

saj, por shprehet vetëm për personat e zgjedhur sipas ligjit elektorat. Sipas këtij subjekti të interesuar, nëse masa ndaluese e pezullimit nga ushtrimi i detyrës e vendosur ndaj anëtarit të Këshillit të Ministrave ose ndaj të gjithë Këshillit të Ministrave ndikon në funksionimin e lirë të pushtetit ekzekutiv, kjo masë merr përmbajtjen e një instrumenti kontrolli dhe balance midis pushteteve. Një instrument i tillë, i cili nuk është i parashikuar në Kushtetutë, por që kushtëzon funksionimin dhe përbërjen e pushtetit ekzekutiv, nuk mund të konsiderohet kushtetues. Po kështu, Presidenti ka parashtruar se nëse masa ndaluese nuk ndikon në funksionimin e lirë dhe të pakushtëzuar të pushtetit ekzekutiv, atëherë kjo masë nuk del nga konteksti penal dhe nuk shndërrohet në instrument kontrolli e balance i pushtetit gjyqësor mbi pushtetin ekzekutiv. Analiza nëse masa ndaluese është ose jo ndërhyrje në tagrat e një pushteti tjetër duhet të sqarohet nga Gjykata dhe Presidenti mbështet çdo vendimmarrje të saj.

42. Nisur nga konteksti i rrethanave të çështjes në shqyrtim, si dhe nga thelbi i pretendimeve e prapësimeve të palëve pjesëmarrëse në gjykim, Gjykata çmon të ndalet fillimisht në identifikimin e qëllimit të kushtetutëbërësit për sa i përket imunitetit të anëtarëve të Këshillit të Ministrave në raport me imunitetin e deputetëve, duke u bazuar për këtë qëllim edhe në jurisprudencën e saj.

43. Paraprakisht, Gjykata vëren se imuniteti i ministrit rregullohet nga neni 103, pika 3 i Kushtetutës, i cili parashikon se anëtarët e Këshillit të Ministrave gëzojnë imunitetin e deputetit. Përderisa kjo dispozitë kushtetuese e trajton imunitetin e ministrit si të njëjtë me atë të deputetit, analiza e regjimit të këtij imuniteti kërkon domosdoshmërisht referimin në nenin 73 të Kushtetutës, ku përcaktohet natyra dhe shtrirja e imunitetit parlamentar. Gjykata vëren se, sipas përmbajtjes aktuale të nenit 73, pika 1, të Kushtetutës, deputeti nuk mban përgjegjësi për mendimet e shprehura në Kuvend dhe votat e dhëna prej tij në ushtrim të funksionit. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastin e shpifjes. Ndërkohë, sipas pikës 2 të po të njëjtit nen, deputeti nuk mund të arrestohet ose t'i hiqet liria në çfarëdolloj forme ose ndaj tij të ushtrohet kontroll personal, ose i banesës, pa autorizimin e Kuvendit. Rastet kur deputeti kapet në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një krimi të rëndë, parashikohen në pikën 3 të nenit 73 të Kushtetutës, sipas të cilit deputeti mund të ndalohet ose të arrestohet pa autorizim, ndërsa Prokurori i Përgjithshëm ose drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme njofton menjëherë Kuvendin, i cili, kur konstaton se nuk ka vend për procedim, vendos për heqjen e masës. Në kontekst të këtyre parashikimeve kushtetuese, Gjykata vlerëson se rregullat e parashikuara në nenin 73 të Kushtetutës janë të zbatueshme edhe për ministrin dhe përbëjnë regjimin kushtetues të imunitetit të tij.

44. Në këndvështrimin historik, Gjykata evidenton se ligji nr. 7491, datë 29.4.1991, “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese” në nenin 22 të tij kishte parashikuar se deputeti i Kuvendit gëzon imunitet, ai nuk mund të pengohet në ushtrimin e detyrave të tij, si dhe në sigurimin e të dhënave që nuk përbëjnë sekret shtetëror. Deputeti nuk mund të kontrollohet, të ndalohet, të arrestohet ose të ndiqet penalisht pa pëlqimin e Kuvendit. Deputeti mund të ndalohet pa pëlqimin e Kuvendit, vetëm në rastet kur kryen një krim të dukshëm e të rëndë. Deputeti nuk ka përgjegjësi ligjore për veprimet që kryen e qëndrimet që mban gjatë ushtrimit të detyrës së tij si deputet ose për votën e dhënë. Ndërsa për sa u përket anëtarëve të Këshillit të Ministrave imuniteti rregullohej në mënyrë të ndryshme, pasi ky ligj parashikonte se ata përgjigjen për veprimtarinë e ministrive përkatëse (neni 39), si dhe përgjigjen penalisht për shkeljen e këtij ligji, si dhe të ligjeve të tjera në lidhje me ushtrimin e funksioneve të tyre. Ndjekja penale e tyre bëhej me miratimin e Kuvendit (neni 41).

45. Me miratimin e Kushtetutës së vitit 1998, neni 73 i Kushtetutës në përmbajtjen e tij fillestare parashikonte: “*Deputeti nuk mund të ndiqet penalisht pa autorizimin e Kuvendit.*

Autorizimi kërkohet edhe në rastin kur ai do të arrestohet.” Ndërkohë, Gjykata vëren se për sa i përket çështjes së imunitetit të ministrit ai u njësua me atë të deputetit, ku në nenin 103, pika 3, të Kushtetutës u përcaktua shprehimisht rregullimi kushtetues i imunitetit të ministrit. Edhe kushtetutëbërësi në debatet për përgjegjësinë penale të ministrave ka vlerësuar se deputetit dhe ministrit duhet t’u sigurohet i njëjti imunitet (*shih Debati Kushtetues 1, faqja 420 dhe Debati Kushtetues 2, faqja 161*). Kjo dispozitë, që nga hyrja në fuqi e Kushtetutës e deri më sot, nuk ka pësuar ndryshime, duke reflektuar qëndrueshmërinë e vullnetit kushtetues për të ruajtur të pandryshuar këtë regjim të veçantë juridik të ministrit.

46. Në këtë pikë, Gjykata sjell në vëmendje se është vënë në lëvizje edhe më parë në lidhje me interpretimin e nenit 103, pika 3, të Kushtetutës, duke u shprehur se kjo dispozitë u jep anëtarëve të Këshillit të Ministrave, në sajë të funksionit të tyre të rëndësishëm shtetëror, një mbrojtje të veçantë ligjore. Duke e barazuar mbrojtjen ligjore të anëtarit të Këshillit të Ministrave me atë të deputetit, Kushtetuta i ka dhënë të njëjtin kuptim juridik imunitetit për këtë kategori funksionarësh. Po sipas Gjykatës, meqenëse vetë Kushtetuta e barazon në aspektin substancial gëzimin e imunitetit të anëtarit të Këshillit të Ministrave me imunitetin e deputetit, edhe procedura që ndiqet për heqjen e imunitetit të deputetit, e parashikuar në nenin 73 të saj, do të jetë e zbatueshme dhe për anëtarin e Këshillit të Ministrave që nuk është deputet (*shih vendimin nr. 38, datë 23.6.2000, të Gjykatës Kushtetuese*).

47. Ndërkohë Gjykata vëren se në vitin 2012, me reformën kushtetuese të imunitetit, e cila kishte për qëllim kufizimin e paprekshmërisë së deputetit nga ndjekja penale, neni 73 i Kushtetutës u ndryshua sipas përmbajtjes aktuale të tij. Sipas kësaj përmbajtjeje, ai i garanton deputetit imunitet në dy forma, *imunitetin substancial* – në kuptim të mospërgjegjësisë për mendimet e shprehura në Kuvend dhe votat e dhëna prej tij në ushtrim të funksionit (paragrafi i parë) dhe *imunitetin procedural* - në kuptim të paprekshmërisë, pra që deputeti nuk mund të arrestohet ose t’i hiqet liria në çfarëdo lloj forme ose ndaj tij të ushtrohet kontroll personal, ose i banesës, pa autorizimin e Kuvendit (paragrafi i dytë).

48. Duke iu referuar qëllimit të kushtetutëbërësit në marrjen e nismës për miratimin e reformës kushtetuese të vitit 2012, që lidhet me regjimin e imuniteteve, Gjykata ka evidentuar se ai synonte kufizimin e paprekshmërisë së deputetit nga ndjekja penale, i cili sipas Kushtetutës së vitit 1998 ishte i plotë (deri në marrjen e një autorizimi nga Kuvendi). Po kështu, Gjykata ka theksuar se rregullat për paprekshmërinë e deputetëve në çështjet penale nuk duhet të shkojnë përtej asaj që është e justifikuar për qëllime të ligjshme dhe rrjedhimisht ato duhet të interpretohen të mënyrë të kufizuar (*shih vendimin nr. 81, datë 21.11.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

49. Po në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se regjimi i imuniteteve, në çdo rast, synon, nga njëra anë, të garantojë ushtrimin e qetë dhe të pandikuar të funksioneve të rëndësishme publike nga zyrtarët e lartë të shtetit, të cilët nuk duhet të druhen se veprimtaria e tyre shtetërore mund të bëhet shkas për pasoja personale, si, për shembull, një padi civile ose një akuzë penale. Nga ana tjetër, sipas Gjykatës, dispozitat që përbëjnë regjimin e imuniteteve synojnë të garantojnë përgjegjshmërinë e këtyre funksionarëve të lartë në qoftë se, në përfundim të verifikimeve përkatëse dhe një procesi të rregullt ligjor, rezulton se veprimet e tyre nuk janë të motivuara nga interesi publik, por nga interesi privat ose keqbesimi (*shih vendimet nr. 1, datë 17.1.2025; nr. 81, datë 21.11.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

50. Për sa i takon regjimit të imuniteteve të deputetit, Gjykata ka theksuar se ai (imuniteti) nuk është privilegj personal i tyre, por qëllimi kryesor i tij (imunitetit parlamentar) është mbrojtja e vet parlamentit dhe në veçanti funksionimi i duhur i tij. Në këtë kuptim, Gjykata ka vlerësuar se duhet të ekzistojë një prezumim themelor që imuniteti duhet të hiqet në të gjitha

rastet kur nuk ka asnjë arsye për të dyshuar se akuzat ndaj deputetit përkatës janë të motivuara politikisht dhe se paprekshmëria e tij duhet të zbatohet vetëm në rastet kur ka arsye për të dyshuar se në vendimin për ndjekjen penalisht të deputetit ka elemente partiako-politike (*shih vendimet nr. 1, datë 17.1.2025; nr. 81, datë 21.11.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

51. Në lidhje me imunitetin procedural të parashikuar nga neni 73, pika 2 i Kushtetutës për deputetin (lexo ministrin), Gjykata ka pohuar se ai (neni) i garanton deputetit mbrojtje të posaçme nga ato veprime procedurale të ndërmarra nga organet ligjzbatuese në kuadër të procedimit penal, të cilat kufizojnë lirinë e tij personale. Gjykata ka theksuar se në këto raste vetë Kushtetuta parashikon një mekanizëm garantues siç është autorizimi i Kuvendit, i cili është i nevojshëm kur masat kufizuese të caktuara ndaj deputetit (ministrit) përbëjnë kufizim/heqje të lirisë së tij personale, që sjell pasoja në vetë të drejtën e deputetit për t'u zgjedhur, në aspektin e ushtrimit të të drejtave të tij si deputet, pra të vet veprimtarisë parlamentare (*shih vendimin nr. 81, datë 21.11.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

52. Në përmbledhje të sa më sipër, Gjykata evidenton se regjimi i imuniteteve për funksionarët e lartë publikë ka ndjekur zhvillimet e vet modelit kushtetues të shtetit. Në fazën fillestare të tranzicionit demokratik kalimi nga një sistem i centralizuar në një model qeverisjeje të mbështetur në parimin e shtetit të së drejtës dhe në ndarjen e balancimit e pushteteve imponoi si domosdoshmëri forcimin e pavarësisë institucionale të pushteteve dhe organeve kushtetuese. Në këtë kontekst, imuniteti u konceptua si një garanci funksionale për të mbrojtur ushtruesit e detyrave të larta shtetërore nga presione ose ndërhyrje të padrejta që mund të cenonin autonominë e tyre në ushtrimin e funksionit. Megjithatë, me konsolidimin e rendit kushtetues dhe forcimin e institucioneve demokratike, u bë e dukshme nevoja për të thelluar standardet e përgjegjshmërisë e llogaridhënies publike dhe garantimin e parimit të barazisë përpara ligjit. Si rrjedhojë, nëpërmjet ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore, regjimi i imuniteteve ka ardhur duke u ngushtuar gradualisht, jo vetëm për deputetët e ministrat, por për të gjithë funksionarët publikë.

53. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se sistemi qeverisës, sipas Kushtetutës, mbështetet në parimin themelor të shtetit të së drejtës, i cili nënkupton se çdo ushtrues i funksioneve publike, pa përjashtim, përfshirë ministrat si anëtarë të pushtetit ekzekutiv, i nënshtrohet rendit juridik dhe mban përgjegjësi në rast të shkeljes së ligjit. Ky parim kërkon që ushtrimi i kompetencave shtetërore të zhvillohet brenda kufijve të përcaktuar nga Kushtetuta dhe ligji. Po kështu, parimi i shtetit të së drejtës lidhet ngushtësisht edhe me parimin e barazisë përpara ligjit, si një nga parimet themelore kushtetuese, sipas të cilit askush nuk gëzon privilegje ose përjashtime nga zbatimi i ligjit për shkak të funksionit që ushtron, përveçse kur ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive sipas nenit 18 të Kushtetutës. Në këtë kuptim, imuniteti i ministrit nuk përbën një privilegj individual ose një formë mbrojtjeje absolute ndaj juridiksionit penal, por një garanci funksionale të kufizuar, e cila synon të sigurojë ushtrimin e lirë dhe të pavarur të detyrës. Kjo garanci nuk mund të shndërrohet në pengesë për ushtrimin e ndjekjes penale ose të juridiksionit gjyqësor përtej rasteve të parashikuara shprehimisht nga Kushtetuta.

54. Në këtë kuadër, Gjykata çmon se epërsia e Kushtetutës, si ligji më i lartë i rendit juridik, zbatimi i drejtpërdrejtë i dispozitave të saj, detyrimi i të gjitha organeve shtetërore për të vepruar brenda bazës dhe kufijve të së drejtës, si dhe parimi i ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, përbëjnë parimet themelore orientuese për interpretimin e çdo norme që prek regjimin e imuniteteve të funksionarëve të lartë. Çdo interpretim që do të zgjeronte fushën e mbrojtjes përtej asaj që parashikon shprehimisht Kushtetuta do të cenonte ekuilibrin kushtetues ndërmjet pushteteve, duke krijuar një trajtim të privilegjuar të papajtueshëm me parimin e barazisë përpara ligjit, pa përligjje të arsyeshme dhe

objektive. Një qasje e tillë do të binte ndesh me vetë logjikën e shtetit të së drejtës, i cili kërkon që përgjegjësia dhe llogaridhënia të jenë elemente thelbësore të ushtrimit të funksioneve publike.

55. Në kuptim të këtyre standardeve kushtetuese, Gjykata çmon se regjimi i imuniteteve, si i deputetit, ashtu edhe i ministrit, përcaktohet drejtpërdrejt në normat kushtetuese. Kjo do të thotë se nuk përjashtohet nga llogaridhënia dhe përgjegjësia as anëtar i Këshillit të Ministrave (ministri). Ai mban përgjegjësi politike përpara Kuvendit për ushtrimin e funksioneve të tij qeverisëse, e cila konkretizohet përmes mekanizmave të kontrollit parlamentar të parashikuar në Kushtetutë dhe që mund të çojë në shkarkimin e tij. Njëkohësisht ai mban edhe përgjegjësi penale individuale, në rast se gjatë ushtrimit të detyrës kryen veprë penale. Gjykata thekson se, ndonëse ndaj ministrave parashikohet një regjim i veçantë imuniteti, ky i fundit ka si qëllim vetëm garantimin e ushtrimit të lirë dhe të pavarur të funksionit publik, duke i mbrojtur ata nga ndërhyrje ose sulme të padrejta me natyrë politike. Edhe pse ndaj ministrave parashikohet një regjim i veçantë imuniteti, ky regjim nuk përbën privilegj personal, por një garanci funksionale që synon të sigurojë ushtrimin e lirë dhe të pavarur të detyrës publike. Ai nuk përbën dhe nuk mund të interpretohet si një mburojë ndaj zbatimit të ligjit penal, pasi ministri, si çdo individ, mbetet subjekt i përgjegjësisë penale dhe është i detyruar t'u nënshtrohet rregullave dhe sanksioneve penale përpara organeve kompetente në rast të kryerjes së një veprë penale.

C.2. Për garancitë e tjera procedurale në këndvështrim të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve

56. Gjykata vëren se ndërsa neni 242, pika 1, i KPP-së ka parashikuar se me vendimin që disponon pezullimin e ushtrimit të një detyre a shërbimi publik, gjykata i ndalon përkohësisht të pandehurit, plotësisht ose pjesërisht, veprimtarinë që lidhet me to, pika 2 e tij përcakton se masa ndaluese e pezullimit të ushtrimit të një detyre a shërbimi publik nuk zbatohet ndaj personave të zgjedhur sipas ligjit elektoral. Duke qenë se masa e pezullimit nga detyra nuk gjen zbatim ndaj një kategorie të caktuar personash, Gjykata çmon të analizojë në vijim nëse në regjimin kushtetues të imuniteteve të ministrit, ashtu sikurse edhe në atë të deputetit, përfshihet apo jo garancia e parashikuar në nenin 242, paragrafi 2, të KPP-së.

57. Gjykata vlerëson se kjo dispozitë ligjore, për nga natyra e saj, përbën një përjashtim të karakterit procedural, i cili nuk gjen mbështetje të drejtpërdrejtë në tekstin kushtetues për sa u përket deputetëve ose ministrave. Në këtë kuptim, Gjykata thekson se një normë ligjore nuk mund të shërbejë si burim për t'i dhënë përmbajtje ose për të zgjeruar kuptimin e një norme kushtetuese përkundrazi, është norma kushtetuese ajo që përcakton kuadrin dhe kufijtë brenda të cilëve duhet të interpretohet dhe zbatohet legjislacioni i zakonshëm. Për rrjedhojë, dispozita e mësipërme nuk mund të konsiderohet pjesë e regjimit kushtetues të imunitetit, i cili është i përcaktuar në mënyrë shteruese nga Kushtetuta.

58. Për sa më sipër, në përfundim, Gjykata vlerëson se neni 242, pika 2, i KPP-së përbën garanci të veçantë procedurale për të zgjedhurit sipas ligjit elektoral. Kjo dispozitë lidhet me mbrojtjen e funksionit përfaqësues dhe me respektimin e parimit të sovranitetit popullor, të sanksionuar në nenin 2 të Kushtetutës, sipas të cilit sovraniteti i përket popullit dhe ushtrohet prej tij përmes përfaqësuesve të zgjedhur. Ashtu siç ka pohuar Gjykata, zgjedhësit delegojnë të drejtën tek i zgjedhuri, që ai të vendosë mbi çështje që lidhen me qeverisjen e vendit. I zgjedhuri ka detyrimin e përfaqësimit real të zgjedhësve dhe mandatin e besuar nga zgjedhësit është i detyruar ta ushtrojë realisht (*shih vendimin nr. 4, datë 23.2.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Për shkak të këtij parimi, garancia ligjore e nenit 242, pika 2, të KPP-së nuk mund të interpretohet si një zgjatim i regjimit të imunitetit përtej kufijve kushtetues, por duhet të kuptohet në funksion të garantimit të integritetit të mandatit përfaqësues dhe të vullnetit të zgjedhësve.

59. Gjykata lidhur me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, të sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës, është shprehur se sipas tij asnjë organ, në përbërje ose jo të një prej tre pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që sipas rastit do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve ose institucioneve të tjera kushtetuese. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se ai shtrihet jo vetëm ndaj tri degëve të pushtetit: ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, por edhe ndaj organeve të tjera kushtetuese të pavarura, kompetencat e të cilave janë të parashikuara nga dispozitat e Kushtetutës (*shih vendimin nr. 15, datë 15.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

60. Në lidhje me objektin e kërkesës, në përfundim të diskutimeve, vlerësimet e gjyqtarëve u ndanë në dy qëndrime dhe Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 2, të Ligjit Organik të saj.

61. Sipas njërit qëndrim, pavarësisht se në kuptimin kushtetues regjimi i imuniteteve nuk përbën përjashtim/mbrojtje nga ndjekja penale, ai nuk mund të kuptohet i shkëputur nga garancitë që lidhen me funksionin kushtetues në fjalë, pra ushtrimin e lirë dhe të pavarur të detyrës. Edhe pse këto garanci zbatohen ndaj funksionarit publik *in personam*, ato synojnë, në thelb, mbrojtjen dhe garantimin e funksionimit të pushtetit të cilit ai i përket, në rastin konkret pushtetit ekzekutiv. Mbi këtë qasje vlerësojmë se ndonëse neni 242, pika 2, i KPP-së parashikon shprehimisht se masa e pezullimit nga detyra nuk zbatohet për të zgjedhurit sipas ligjit electoral, qëllimi i tij është garantimi i ushtrimit të funksioneve të prejardhura nga vota e sovranit, pra ai përmban garancitë procedurale të nevojshme për të mundësuar vetë ushtrimin e funksionit kushtetues.

62. Për sa i përket mënyrës se si zbatohen këto garanci në rastin e ministrit ato duhet të shihen në raport me drejtpeshimin e parimit kushtetues të efektivitetit të ndjekjes penale e ushtrimit të funksionit gjyqësor dhe parimit të ushtrimit të lirë të funksionit ekzekutiv. Kjo do të thotë se masa e pezullimit nga detyra duhet të analizohet në raportin që shfaqet midis kompetencës që ushtrohet nga prokuroria, si organi kushtetues i ngarkuar me ndjekjen penale dhe asaj të ushtrimit të funksionit nga pushteti gjyqësor, nga njëra anë, si dhe kontrollit politik, që ushtrohet nga pushteti legjislativ ndaj atij ekzekutiv në një republikë parlamentare, nga ana tjetër.

63. Në arritjen e këtij qëndrimi nisemi nga premisa se interpretimi i dispozitave kushtetuese mbështetet në leximin sistematik dhe harmonik të tyre dhe se normat kushtetuese nuk mund të interpretohen si norma të izoluar. Në këtë kuptim, asnjë dispozitë e Kushtetutës nuk mund të nxirret jashtë kontekstit të saj dhe të interpretohet më vete, pasi çdo dispozitë kushtetuese duhet të interpretohet në mënyrë që të jetë e pajtueshme me parimet themelore kushtetuese, pasi të gjitha normat dhe parimet kushtetuese formojnë një sistem harmonik, pa kontradikta të brendshme (*shih vendimin nr. 29, datë 30.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar se rregullimet që bën Kushtetuta nuk mund të jenë gjithmonë të plota ose shteruese, pasi ajo nuk ka për qëllim të rregullojë hollësisht çdo çështje të organizimit të jetës politiko-shoqërore të një vendi (*shih vendimet nr. 55, datë 27.7.2016; nr. 22, datë 24.4.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta, nuk mund ta bëjë ligji. Prandaj nuk mund të pranohet se ajo ka ometuar pa përmendur raste të tilla (...) atje ku nuk është shprehur (*shih vendimet nr. 10, datë 26.2.2015; nr. 25, datë 15.12.2008; nr. 212, datë 29.12.2002, të Gjykatës Kushtetuese*).

64. Kushtetuta, si ligji themelor i shtetit, detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese. Referuar përmbajtjes së dispozitave kushtetuese që përcaktojnë marrëdhënien mes pushtetit ekzekutiv dhe atij legjislativ, qeveria buron nga shumica parlamentare dhe mban përgjegjësi politike

përpara Kuvendit (nenet 95, 96, 97, 100 dhe 102 të Kushtetutës). Baza e përgjegjësisë parlamentare është raporti që krijohet në marrëdhëniet ndërmjet Kuvendit dhe qeverisë (*shih vendimin nr. 26, datë 25.5.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Emërimi dhe shkarkimi i ministrave janë të lidhur ngushtë me rolin e Kuvendit si organ përfaqësues i sovranitetit popullor (neni 98 i Kushtetutës) për sa kohë që dekreti i Presidentit bëhet objekt vlerësimi nga Kuvendi, i cili vendos për miratimin ose mosmiratimin e tij. Pjesëmarrja e ekzekutivit në veprimtarinë e Kuvendit dhe marrëdhënia e besimit që ekziston mes tyre është kushti thelbësor për zbatimin e drejtimit politik të vendit. Në këtë kuptim, marrëdhënia mes ekzekutivit dhe ligjvënësit (shumicës parlamentare) realizohet brenda vetë organit legjislativ, i cili, përveç funksionit kryesor të ligjbërjes ushtron edhe kompetenca të rëndësishme kontrolli mbi veprimtarinë e pushtetit ekzekutiv përmes instrumenteve të përcaktuara në normat kushtetuese dhe bazuar në parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

65. Thënë kjo, nga njëra anë, është e qartë se vendosja e masës së pezullimit nga detyra ndaj një anëtari të Këshillit të Ministrave (ministrit), e cila nuk parashikohet shprehimisht nga Kushtetuta, për nga natyra dhe intensiteti i saj përbën ndërhyrje të drejtpërdrejtë në ushtrimin e detyrës së tij. Bazuar në kompetencat që Kushtetuta i njej ministrit (neni 102, pika 4, i Kushtetutës), pezullimi nga detyra prek vetë thelbin e funksionit kushtetues politik të ministrit, i cili nuk mund të shihet i shkëputur nga kompetencat kushtetuese që i janë njohur pushtetit ekzekutiv si i tillë, me qëllim ushtrimin e veprimtarisë së tij për përcaktimin e drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore (neni 100, pika 1, i Kushtetutës). Duke shkuar edhe më tej, referuar pozicionit të ekzekutivit në një republikë parlamentare dhe rolit të veçantë të Kuvendit për formimin e Këshillit të Ministrave që diktohet nga dhënia e besimit politik, rrjedh se përgjegjësia politike e Këshillit të Ministrave në ushtrimin e funksionit të tij qeverisës përcaktohet nga Kuvendi. Kjo i atribuon këtij të fundit kompetencën ekskluzive për të vlerësuar (mos)zbatimin e garancive procedurale edhe në ato raste kur kërkohet caktimi i një mase në funksion të procedimit penal të anëtarit të organit ekzekutiv, e cila passjell ndërprerjen e përkohshme të kompetencave që burojnë nga detyra e tij.

66. Nga ana tjetër, duke vënë theksin edhe në rolin dhe kompetencat kushtetuese të organit të akuzës, që, sipas nenit 148 të Kushtetutës, është titullari i ndjekjes penale, vlerësojmë se interesi publik për hetimin dhe ndjekjen penale efektive nënkupton domosdoshmërinë e zhvillimit të një procesi penal të paanshëm dhe proporcional, të orientuar drejt përcaktimit të përgjegjësisë penale në përputhje me garancitë kushtetuese, si dhe kërkon zhveshjen e funksionarëve publikë nga ato privilegje që do të bëheshin pengesë ose do të mundësonin shmangien e përgjegjësisë penale.

67. Është ky interes publik që, në raport me interesin tjetër publik që ka të bëjë me zhvillimin e politikave të qeverisjes dhe drejtimin politik të vendit, kërkon përfshirjen e Kuvendit, si organi kushtetues që duhet të verifikojë respektimin dhe zbatimin e atyre garancive procedurale (jo privilegje), me qëllim që të evitohet rreziku për ndërhyrje të një pushteti (organi të tij) mbi tjetrin. Pra, nevoja për të balancuar këto dy interesa publikë që konkurrojnë ngushtë me njëri-tjetrin bën të nevojshëm mekanizmin zhblllokues të autorizimit të organit legjislativ.

68. Po kështu, edhe pse në rastin e deputetit këto garanci janë të tilla që ndalojnë pezullimin e tij, në vlerësimin tonë, edhe në rastin e ministrit, për sa kohë që masa e pezullimit është e tillë që sjell pasoja në ushtrimin e funksioneve kushtetuese të njërit prej pushteteve, është e nevojshme thirrja e Kuvendit, si organi që duhet të vlerësojë dhe verifikojë masën e kërkuar nga organi i akuzës. Prandaj, për të garantuar balancimin ndërmjet interesit kushtetues për ushtrimin efektiv të ndjekjes penale dhe funksionimit të rregullt të pushtetit ekzekutiv, edhe masa kufizuese e

pezullimit do të duhet të kushtëzohet me autorizimin paraprak të Kuvendit, si mekanizëm kontrolli dhe ekuilibrimi institucional.

69. Bazuar në këtë analizë, edhe pse kemi mbajtur qasjen se masa e pezullimit nga detyra sipas nenit 242, pika 2, të KPP-së, nuk përfshihet në regjimin kushtetues të imunitetit të deputetit/ministrit kjo nuk është e mjaftueshme për të përjashtuar *a priori* domosdoshmërinë e një vlerësimi të kësaj mase, që përbën një garanci për funksionarin publik gjatë ushtrimit të detyrës. Vetë Kushtetuta, në frymën e saj, ndërsa synon respektin e ndërsjellë ndërmjet pushteteve, garanton edhe kontrollin mes tyre, përmes mekanizmave të ndryshëm, që në rastin e ministrit është i lidhur me raportin që ekziston mes pushtetit legjislativ dhe atij ekzekutiv në një republikë parlamentare. Nga ana tjetër, Kushtetuta nuk përmban asnjë ndalim ose kufizim për mundësinë e ushtrimit të kësaj forme kontrolli nga ana e pushtetit ligjvënës, e cila përfshin edhe verifikimin e zbatimit të garancive ligjore të funksionit politik të ministrit. Për rrjedhojë, çdo masë që sjell ndërprerjen/pezullimin, qoftë edhe të përkohshëm, të ushtrimit të funksionit të një ministri, prek drejtpërdrejt raportin e përgjegjshmërisë politike në aspektin procedural ndërmjet pushtetit ekzekutiv dhe atij legjislativ.

70. Në kuptim të sa më sipër, vlerësojmë se balancimi ndërmjet interesit publik për ndjekje penale efektive e ushtrimit të funksionit gjyqësor dhe atij për garantimin e funksionimit efektiv të pushtetit ekzekutiv kërkon detyrimisht ndërmjetësimin e Kuvendit, nëpërmjet autorizimit paraprak të tij, gjë që nuk buron nga zgjerimi i regjimit të imuniteteve përtej vullnetit të kushtetutëbërësit, por rrjedh nga nevoja për të ruajtur ekuilibrin kushtetues ndërmjet pushteteve dhe për të garantuar që ndërhyrja në përbërjen dhe funksionimin e pushtetit ekzekutiv (qeverisë) të mos realizohet pa pjesëmarrjen e vetë organit që mban përgjegjësinë politike për të.¹

71. Sipas qëndrimit tjetër, çështja konkrete nuk mund të zgjidhet as vetëm përmes interpretimit të izoluar të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës dhe as nëpërmjet interpretimit të zgjeruar evolutiv të tij, që krijon një normë të re kushtetuese. Ajo kërkon një analizë sistemike të mekanizmave që garantojnë ushtrimin e pushtetit ekzekutiv në arkitekturën tonë kushtetuese (strukturën normative dhe institucionale) nga arbitrariteti i prokurorisë dhe pushtetit gjyqësor, si dhe zgjedhjet e bëra nga kushtetutëbërësi. Arkitektura jonë kushtetuese bazohet, ndër të tjera, në parimet themelore të epërsisë së Kushtetutës dhe shtetit të së drejtës (neni 4), rregullimit me ligj të organizimit dhe funksionimit të organeve kushtetuese (neni 6), ndarjes dhe balancimit të pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor (neni 7) dhe barazisë para ligjit (neni 18). Këto parime, nga njëra anë, përbëjnë shtyllat mbi të cilat ndërtohen institucionet dhe, nga ana tjetër, shërbejnë për të vlerësuar kushtetutshmërinë e mekanizmave të ndërveprimit dhe kontrollit ndërmjet pushteteve. Në këtë kuadër shtrohet pyetja nëse masa e pezullimit nga ushtrimi i detyrës publike, sipas nenit 242 të KPP-së, ndaj një ministri është e tillë që kërkon autorizimin paraprak të Kuvendit, si garanci për të ruajtur ushtrimin e kompetencave të pushtetit ekzekutiv.

72. Neni 73, pika 2, i Kushtetutës parashikon autorizimin paraprak të Kuvendit vetëm për masat e listuara shprehimisht në të: arrestimin, heqjen e lirisë në çdo formë, kontrollin personal dhe kontrollin e banesës. Pezullimi nga detyra qartazi nuk përfshihet në këtë listë. Normat për imunitetin kanë karakter përjashtimor dhe, si të tilla, interpretohen ngushtë (*shih vendimin nr. 81 datë 21.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Neni 73 i Kushtetutës përbën një normë të qartë, të vetëzbatueshme dhe të plotë për imunitetin. Mungesa e masës së pezullimit në tekstin e nenit 73 përbën zgjedhje të ligjvënësit kushtetues dhe nuk mund të tejkalohet me interpretim. Zgjerimi i imunitetit përmes interpretimit do të përbente krijim norme të re kushtetuese, në kundërshtim me kompetencat e Gjykatës dhe parimin e epërsisë dhe zbatimit të drejtpërdrejtë të Kushtetutës. Reforma kushtetuese e vitit 2012 synoi pikërisht ngushtimin e imunitetit

¹ Votuan sipas këtij qëndrimi Kryetarja Fiona Papajorgji dhe gjyqtarët Sonila Bejtja, Sandër Beci dhe Marjana Semini.

procedural për deputetët, ministrat dhe gjyqtarët, ndërsa ajo e vitit 2016 e reduktoi edhe më ndjeshëm për gjyqtarët. Ky orientim kushtetues nxjerr në pah vullnetin e qartë të kushtetutëbërësit për të kufizuar rastet kur kërkohet autorizim për marrjen e masave procedurale penale, e jo për t'i zgjeruar ato. Në këtë mënyrë Kushtetuta ka reflektuar zhvendosjen e theksit nga nevoja për mbrojtjen e funksionit drejt garantimit të barazisë përpara ligjit dhe forcimit të përgjegjësisë juridike.

73. Masa e pezullimit sipas nenit 242 të KPP-së nuk cenon lirinë personale dhe nuk prek të drejta themelore në kuptim të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës (integritetin personal dhe banesën), ndaj nuk mund të krahasohet me masat e imunitetit të listuara në Kushtetutë. Ajo synon mbrojtjen e integritetit të procesit penal, duke parandaluar rrezikun që ushtrimi i funksionit publik ekzekutiv të pengojë hetimin. Pretendimi se kjo masë cenon ndarjen e pushteteve, pasi ndikon në funksionimin e Këshillit të Ministrave, mbështetet në një premisë jo të saktë, pasi masa drejtohet ndaj individit dhe jo ndaj institucionit. Kompetencat e institucionit mbeten të paprekura dhe mund të ushtrohen sipas mekanizmave kushtetues të zëvendësimit, duke garantuar vijimësinë e funksionimit të pushtetit ekzekutiv. Efektet faktike që një masë procedurale mund të ketë mbi ushtrimin e përkohshëm të funksionit ekzekutiv nuk përbëjnë, në vetvete, cenim të ndarjes së pushteteve, për sa kohë organet e drejtësisë veprojnë brenda kompetencave të tyre kushtetuese dhe ligjore.

74. Qëllimi historik i imunitetit parlamentar ka qenë mbrojtja ndaj ndërhyrjeve arbitrare për motive me karakter politik, veçanërisht në sisteme ku pavarësia e gjyqësorit nuk ishte e garantuar si duhet. Kjo mbrojtje nuk duhet të shkojë përtej asaj që është e nevojshme dhe nuk duhet të përdoret si instrument për të penguar drejtësinë (*shih Përmbledhje e opinioneve dhe raporteve të Komisionit të Venecias për autonominë parlamentare, CDL-PI(2025)014, datë 18.12.2025*). Megjithatë, arkitektura aktuale kushtetuese e sistemit të drejtësisë, pas reformës së vitit 2016, ka ndërtuar një regjim të fuqishëm garancish kundër arbitraritetit dhe procedimit për motive politike. Gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë iu nënshtruan rivlerësimit kalimtar për integritetin, profesionalizmin dhe pasurinë sipas Aneksit të Kushtetutës. Kjo e fundit garanton pavarësinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve (neni 145), vetëqeverisjen përmes Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në përbërje të të cilëve nuk ka asnjë funksionar politik (nenet 147 dhe 149), sistemin e pavarur të emërimit dhe ngritjes në detyrë, si dhe përgjegjësinë disiplinore përmes Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke ia hequr ministrit të Drejtësisë (nenet 147/d dhe 147/ë), si dhe prokurorinë dhe gjykatën e specializuar për ndjekjen e korrupsionit dhe krimin të organizuar (nenet 135, pikat 2 dhe 4, si dhe 148/dh). Imuniteti procedural i gjyqtarëve është eliminuar, ndërsa ai substancial është kufizuar. Këto masa kanë synuar që të zhveshin pushtetin gjyqësor nga ndikimi i politikës së ditës, si burimi kryesor i “frikës” për procedime penale selektive. Ato përbëjnë garanci strukturore që reduktojnë ndjeshëm rrezikun e ndjekjes penale për motive politike ose arbitrare ndaj funksionarëve të lartë. Për më tepër, çdo masë procedurale i nënshtrohet kontrollit gjyqësor në disa shkallë, deri në Gjykatën e Lartë, ndërsa veprimet në keqbesim të gjyqtarit sjellin përgjegjësi për të (neni 137 i Kushtetutës). Në këto kushte, nuk mund të pranohet se mbrojtja e sferës kushtetuese të pushtetit ekzekutiv kërkon zgjerim interpretativ të imunitetit përtej asaj që parashikon shprehimisht Kushtetuta.

75. Parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve nuk nënkupton izolim të pushteteve nga njëri-tjetri, por ndërveprim të strukturuar sipas mekanizmave të parashikuar shprehimisht në Kushtetutë. Ushtrimi i kompetencave të ndjekjes penale nga organi i akuzës dhe pushteti gjyqësor, edhe kur prek funksionarë të lartë të pushtetit ekzekutiv, është pjesë e këtij ndërveprimi, për sa kohë respektohen kufijtë kushtetues dhe pezullimi prek individin e jo

institucionin, në kuptimin që nuk dikton riorganizim të detyruar të kabinetit qeveritar. Parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve plotësohet nga ai i *luajalitetit kushtetues*, i cili i shërben një modeli qeverisjeje ku mekanizmat veprojnë në mënyrë efikase për ta bërë Kushtetutën funksionale (*shih vendimet nr. 26, datë 25.5.2021; nr. 41, datë 19.7.2012; nr. 24, datë 9.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Në një demokraci parlamentare këto dy parime shërbejnë së bashku për të parandaluar përqendrimin e pushtetit dhe për të garantuar shtetin e së drejtës. Ndërsa parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve ofron mekanizmat strukturorë që u mundësojnë pushteteve të kufizojnë njëri-tjetrin, *luajaliteti kushtetues* garanton që organet kushtetuese t'i qëndrojnë besnike vetë sistemit dhe që mekanizmat strukturorë të vihen në veprim sipas qëllimit të mirëfilltë të tyre e, për pasojë, vendi të qeveriset sipas parimit të shtetit të së drejtës.

76. Imuniteti kushtetues nuk është përjashtim i përgjithshëm nga juridiksioni penal, por mekanizëm i kufizuar ekuilibru, i konceptuar për raste të caktuara dhe të përcaktuara qartë. Çdo zgjerim i tij përtej rasteve të parashikuara shprehimisht do të cenonte barazinë para ligjit dhe do të binte ndesh me orientimin e reformave kushtetuese të viteve 2012 dhe 2016.

77. Në përmbledhje të argumenteve të mësipërme, masa e pezullimit nga ushtrimi i detyrës publike, sipas nenit 242 të KPP-së, ndaj një ministri nuk mund të kërkojë autorizim paraprak të Kuvendit dhe nuk përfshihet në garancitë e imunitetit, pasi: a) nuk përfshihet në listën e masave të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës; b) normat për imunitetin interpretohen ngushtë dhe nuk lejojnë zgjerim ose krijim të normave të reja nëpërmjet interpretimit; c) arkitektura aktuale kushtetuese ofron garanci të mjaftueshme kundër ndjekjes penale arbitrare për motive politike; ç) efektet faktike për ushtrimin e funksionit nuk synojnë institucionin, por individin që dyshohet se nëse vijon kryerjen e detyrës mund të dëmtojë rëndë hetimin penal dhe nuk përbëjnë, në vetvete, cenim të ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Për këto arsye, interpretimi i zgjeruar i mbrojtjes kushtetuese përtej rasteve të parashikuara shprehimisht në nenin 73, pika 2, nuk gjen mbështetje në tekstin, frymën dhe arkitekturën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në respekt të epërsisë së Kushtetutës dhe të kufijve që ajo vendos për ushtrimin e pushtetit publik, shtimi ose zgjerimi i rasteve kur kërkohet autorizim paraprak i Kuvendit nuk mund të realizohet nëpërmjet interpretimit gjyqësor, por vetëm nëpërmjet një ndërhyrjeje të shprehur në nivel kushtetues.²

78. Për sa më lart, Gjykata vëren se në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, kërkesa e kërkuarit konsiderohet e rrëzuar.

79. Për sa i përket masës së pezullimit të vendimeve gjyqësore të vendosur me vendimin e datës 12.12.2025 të Mbledhjes së Gjyqtarëve, Gjykata çmon se në kushtet kur ajo vendosi rrëzimin e kërkesës, kjo masë pezullimi duhet të hiqet. Në përputhje me nenin 45 të Ligjit Organik të Gjykatës dhe 27 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, pezullimi vazhdon deri në datën e hyrjes në fuqi të vendimit përfundimtar të Gjykatës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, shkronja “ç” dhe 134, pika 1, shkronja “b”, të Kushtetutës, si dhe neneve 54, 55, 56, 72 dhe 73, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

² Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahimi, Asim Vokshi dhe Ilir Toska.

1. Rrëzimin e kërkesës.
 2. Heqjen e masës së pezullimit të caktuar me vendimin e datës 12.12.2025 të Mbledhjes së Gjyqtarëve.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 6.2.2026.

Shpallur më 3.3.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Asim Vokshi, Sandër Beci.

MENDIM PARALEL

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuarit, Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës së krijuar ndërmjet Kryeministrit dhe Këshillit të Ministrave, nga njëra anë, dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nga ana tjetër, për pezullimin e ushtrimit të detyrës së anëtarit të Këshillit të Ministrave, ne, gjyqtarët Marsida Xhaferllari dhe Asim Vokshi, jemi të qëndrimit se në shtesë të argumenteve të parashtruara në vendim, kërkesa duhej të ishte rrëzuar edhe për një shkak tjetër, atë të mungesës së mosmarrëveshjes së kompetencave. Këtë qëndrim kemi mbajtur edhe më herët (në fazën e shqyrtimit paraprak të pranueshmërisë së saj nga Mbledhja e Gjyqtarëve), duke vlerësuar se për këtë shkak kërkesa ishte haptazi e pabazuar, ndaj duhej të ishte vendosur moskalimi i saj në seancë plenare. Në interpretim të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 41 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, parashtrojmë, në vijim, argumentet që mbështesin qëndrimin tonë.

2. Një mosmarrëveshje kompetence, që paraqitet për zgjidhje përpara Gjykatës, duhet të ketë natyrë kushtetuese, në kuptimin që subjektet e përfshira në konflikt të jenë të parashikuara nga Kushtetuta dhe që kompetenca e pretenduar të përcaktohet si e tillë po nga dispozitat kushtetuese. Në këtë mënyrë, gjykimi në Gjykatë përqendrohet, pikësepari, në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës, për sa u takon funksioneve të nivelit kushtetues, duke gjetur dhe cilësuar të papajtueshmë me Kushtetutën shkakun vendimtar që ka sjellë lindjen e mosmarrëveshjes (*shih vendimin nr. 36, datë 1.6.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, konflikti i kompetencave mund të ekzistojë nëse dy organe/pushtete pretendojnë ushtrimin e së njëjtës kompetencë ose kur asnjëri prej dy organeve/pushteteve nuk merr përsipër ushtrimin e një kompetence (*shih vendimet nr. 12, datë 20.5.2008; nr. 20, datë 4.5.2007; nr. 26, datë 4.12.2006, të Gjykatës Kushtetuese*).

3. Mbi bazën e kësaj jurisprudence, shumica ka vlerësuar se masa e pezullimit nga detyra, e caktuar ndaj zëvendëskryeminstres nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë duket se ka sjellë efekte institucionale në ushtrimin e funksioneve kushtetuese të ministrit dhe në funksionimin e Këshillit të Ministrave. Për këtë arsye, çështja e paraqitur ka rëndësi kushtetuese për kufijtë ndërmjet ushtrimit të funksionit gjyqësor dhe sferës së kompetencave të pushtetit ekzekutiv. Pra, përpara Gjykatës është paraqitur në dukje një mosmarrëveshje kompetencash, konkrete dhe me natyrë kushtetuese, ndërmjet pushtetit ekzekutiv dhe atij gjyqësor, e cila hyn në juridiksionin e saj sipas nenit 131, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës (*shih paragrafët 29, 31 të vendimit*).

4. Nuk pajtohemi me këtë qëndrim të shumicës, pasi vlerësojmë se, ndonëse Kryeministri, Këshilli i Ministrave, Prokuroria e Posaçme dhe GJKKO-ja e Shkallës së Parë janë organe kushtetuese, nuk ekziston premisa “ushtrimi i së njëjtës kompetencë prej tyre” ose “ushtrimi i

kompetencës nga njëri organ që pengon ushtrimin e kompetencave nga organi tjetër”. Caktimi i masës së pezullimit nga detyra të ministrit në kuadër të procedimit penal është pjesë e kompetencës së ushtrimit të ndjekjes penale dhe të dhënies së drejtësisë që Kushtetuta në nenet 135, 148 dhe 148/dh ia jep Prokurorisë së Posaçme dhe GJKKO-së së Shkallës së Parë. Kjo kompetencë përbën objektin qendror të veprimtarisë së tyre dhe asnjë pushtet tjetër nuk mund të ndërhyjë në të. Nën të njëjtin argument, duhet theksuar se Kushtetuta nuk i njeh as Kryeministrit dhe as Këshillit të Ministrave kompetencën për pezullimin nga detyra të ministrit. Masa penale e sigurimit me natyrë ndaluese e pezullimit nga detyra nuk mund të barazohet me shkarkimin nga detyra të ministrit dhe, për rrjedhojë, nuk mund të pranohet se efektet e saj zvogëlojnë ose ndërhyjnë në kompetencën kushtetuese të Kryeministrit për të propozuar shkarkimin nga detyra të ministrit ose që zvogëlojnë funksionet e Këshillit të Ministrave. Pranimi i të kundërtës nuk pajtohet me frymën e parimit të ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, si dhe atë të pavarësisë së pushtetit gjyqësor.

5. Në vlerësimin tonë, kërkesa është haptazi e papranueshme. Nisur nga mënyra e formulimit të objektit dhe përmbajtjes së saj, kërkesa, në thelb, nuk synon zgjidhjen e ndonjë mosmarrëveshjeje kompetencash midis pushtetit ekzekutiv dhe atij gjyqësor (sepse dukshëm nuk ka një të tillë në nivel kushtetues), por anulimin e vendimeve individuale gjyqësore (përfshirë dhe pezullimin e tyre) të dhëna kundër zëvendëskryeminstres dhe ministres, nën pretendimin se nga interpretimi i pikës 3 të nenit 103 të Kushtetutës rrjedh kuptimi se “Anëtar i Këshillit të Ministrave, duke gëzuar imunitetin e deputetit, përfiton nga të gjitha garancitë procedurale që i njeh jo vetëm Kushtetuta këtij të fundit, por edhe legjislacioni procedural penal”. Pra, thelbi i pretendimit të kërkuarit është se njëjtë siç deputeti nuk mund të pezullohet nga ushtrimi i mandatit përfaqësues ligjvënës konform paragrafit të dytë të nenit 242 të KPP-së, ashtu edhe ministri, duke u barazuar për nga garancitë me deputetin, nuk mund të pezullohet nga ushtrimi i mandatit ekzekutiv si ministër, pasi cenohet edhe parimi i ndarjes dhe balancimit midis pushteteve.

6. Lidhur me këtë pretendim, vlerësojmë se, ashtu sikurse Gjykata konstatoi njëzëri, sipas neneve 73 e 103 të Kushtetutës, regjimi i imunitetit të ministrit nuk ka lidhje me ndalimin e vendosjes së masës së sigurimit me karakter ndalues të pezullimit nga detyra ose shërbimi publik, sipas nenit 242 të KPP-së. Këto janë institute të ndryshme që rregullojnë aspekte të ndryshme procedurale penale. Po kështu, jemi pjesë e pohimit njëzëri të Gjykatës se kuptimi i normave kushtetuese nuk mund të rrjedhë nga normat inferiore në hierarki, por e kundërta është e vërtetë. Pra, Kushtetuta nuk kuptohet duke u nisur nga normat e zakonshme ligjore, por këto të fundit duhen lexuar e kuptuar nën dritën e normave kushtetuese. Këto konstatime, të lidhura me arsyen e paraqitjes së kësaj kërkeje nga kërkuari, përjashtonin krejtësisht mundësinë e ekzistencës së një mosmarrëveshjeje kompetencash midis pushtetit ekzekutiv dhe atij gjyqësor, në rastet kur ndaj një ministri zbatohet masa penale ndaluese e sigurimit e parashikuar nga neni 242 i KPP-së. Duke mos qenë pjesë e imunitetit të tij, ministri nuk gëzon garancitë procedurale të nenit 242 të KPP-së.

7. Neni 242, pika 2, i KPP-së, duke përjashtuar zbatimin e masës së pezullimit nga detyra ndaj personave të zgjedhur sipas ligjit elektoral, në thelb, ka synuar të mbrojë legjitimitetin demokratik të përfaqësuesit të zgjedhur nga populli, si bartës i pushtetit sovran në republikën tonë parlamentare. Nuk është e tepërt të evidentohet se sipas nenit 2 të Kushtetutës, sovraniteti i përket popullit, i cili e ushtron atë edhe nëpërmjet përfaqësuesve të tij, të cilët zgjidhen bazuar në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike. Për këtë arsye, neni 242, pika 2, i KPP-së, ka përcaktuar shprehimisht ndalimin e pezullimit të të zgjedhurve sipas vullnetit popullor, pasi këta përbëjnë bërthamën nga e cila lind dhe merr legjitimitet demokratik sistemi qeverisës, mbi bazën e udhëzimeve që sovranin miraton në Kushtetutë dhe në ligje. Njëjtë siç nuk mund të kufizohet delegimi i sovranitetit nga populli te përfaqësuesit e tij, përveç kur Kushtetuta parashikon shprehimisht ndryshe (*p.sh., nëse përfaqësuesi është në kushtet e ndalimit për t'u*

zgjedhur sipas nenit 6/1 të Kushtetutës), ashtu edhe nuk mund të pezullohet i zgjedhuri nga sovrani që të ushtrojë vullnetin sovran, nëpërmjet masës së sigurimit me karakter ndalues, pasi përfaqësuesi si individ është ushtruesi i mandatit që i jep populli.

8. Çdo zyrtar tjetër që ushtron detyra që nuk rrjedhin drejtpërdrejt nga zgjedhjet është mbajtës i një pozite që nuk e çon potencialisht vendin në zgjedhje, kur ndaj tij caktohet masa ndaluese e pezullimit nga detyra. Për rrjedhojë, një zyrtar i tillë nuk gëzon garancitë e parashikuara nga neni 242, pika 2, i KPP-së. Zyrtarët, pushteti i të cilëve derivon në mënyrë të tërthortë prej Kuvendit, mund të pezullohen nga detyra nëse organi i ndjekjes penale argumenton me prova dhe gjykata vendos se ata nëpërmjet qëndrimit në detyrë rrezikojnë të dëmtojnë provat ose të kryejnë të njëjtën vepër penale për të cilën akuzohen, ose ndonjë vepër penale më të rëndë. Ministri ushtron funksion ekzekutiv dhe, si i tillë, nuk konsiderohet i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli sipas Kodit Zgjedhor, për rrjedhojë nuk gëzon garancitë e nenit 2 të Kushtetutës, nga të cilat rrjedh ndalimi i nenit 242, pika 2, të KPP-së. Rrjedhimisht, ministri si funksionar shtetëror nuk gëzon ndonjë mbrojtje të veçantë në raport me zyrtarët e tjerë që përbëjnë pushtetin ekzekutiv ose zyrtarët e institucioneve të tjera kushtetuese të pavarura, për sa i përket zbatimit ndaj tij të parashikimeve të nenit 242 të KPP-së.

9. Mosmarrëveshja e paraqitur për zgjidhje nga kërkuesi nuk përbën mosmarrëveshje kompetencash edhe për një arsye tjetër. Nëpërmjet vendimeve të gjykatës së posaçme objekt i kësaj kërkeje kushtetuese, Kryeministrit ose Këshillit të Ministrave nuk i është marrë, bllokuar, paralizuar ose vështirësuar institucionalisht ushtrimi i kompetencave të tyre kushtetuese. Kërkuesi i ka të pacenuara kompetencat kushtetuese për zgjidhjen e situatës kur individ i caktuar si ministër është në pamundësi objektive për ushtrimin e detyrës. Këtu duhet mbajtur parasysh se neni 242 i KPP-së nuk bllokon kompetencat e ministrit si institucion, por ndalon individin e marrë të pandehur që të dëmtojë procesin penal nëpërmjet ushtrimit të funksioneve ekzekutive. Ndaj nuk ka bazë kushtetuese argumenti se bllokohet veprimtaria ekzekutive e Këshillit të Ministrave duke u marrë masa ndaluese nga gjykata penale, ajo e pezullimit nga detyra të individit, që është emëruar të ushtrojë detyrën e zëvendëskryeministrit dhe të ministrit. Pamundësia e individit për të ushtruar detyrën e ministrit është e zgjidhshme kushtetutshmërisht, me anë të ushtrimit të kompetencave kushtetuese nga Kryeministri dhe rrjedhimisht nuk mund të çojë në paralizimin e pushtetit ekzekutiv. Duhet theksuar se pamundësia e një ministri për të ushtruar detyrën mund të ndodhë për shkaqe të shumta objektive (*p.sh: paaftësi fizike për kohë të gjatë, heqja e zotësisë për të vepruar me vendim të gjykatës civile, dënimi penal me burgim nga gjykata penale me vendim përfundimtar të formës së prerë apo pezullimi nga detyra me vendim gjykatë nëpërmjet zbatimit të masës së sigurimit me karakter ndalues të parashikuar nga neni 242 i KPP-së*). Kjo nuk do të thotë se shkaktohet mosmarrëveshje kompetencash midis pushteteve, në ato raste kur shkaku lidhet ose rrjedh nga një vendim gjyqësor që në procedurën e marrjes së tij nuk ka cenuar autorizimet që kërkon regjimi kushtetues i imunitetit.

10. Vullneti politiko-juridik për emërimin e një individ i detyrën e zëvendëskryeministrit ose ministrit nuk konfliktohet me vendimet gjyqësore penale që i pamundësojnë individit të emëruar që përkohësisht ose plotësisht të vijojë të ushtrojë detyrën publike. Në këtë rast individual, Prokuroria e Posaçme dhe Gjykata e Posaçme kanë vepruar në përputhje me kompetencën kushtetuese të ushtrimit të ndjekjes penale dhe të dhënies së drejtësisë penale të specializuar për shkak të subjektit (ministër), të përcaktuar në nenet 135, 148 dhe 148/dh të Kushtetutës. Pra, organet e drejtësisë kanë ushtruar kompetencat e tyre, pa marrë ose cenuar kompetencat e asnjë institucioni shtetëror, sepse kompetenca për caktimin e masave ndaluese të sigurimit ndaj zyrtarëve që nuk janë të zgjedhur sipas ligjit elektoral, u përket vetëm gjykatave, kur përmbushen kushtet

dhe kriteret për caktimin e këtyre masave të sigurimit. Edhe në këtë prizëm, *prima facie* nuk ka mosmarrëveshje kompetencash midis pushteteve.

11. Në këtë pikë, vëmë në dukje se në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se në kuptim të parimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor, të sanksionuar në nenin 145 të Kushtetutës, gjykatat kanë të drejtën ekskluzive për dhënien e drejtësisë (*shih vendimin nr. 11, datë 2.4.2008, të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas nenit 7 të Kushtetutës, sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënëse, ekzekutive dhe gjyqësore. Në zbatim të parimit bazë të shtetit të së drejtës dhe atij të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, kushtetutëbërësi ka përcaktuar, për secilin nga organet që përfaqësojnë këto pushtete, kompetencat që i përgjigjen qëllimit të tij. Për sa kohë këto kompetenca janë të përcaktuara nga normat kushtetuese, është e palejueshme që një organ tjetër t'i marrë ose t'i anashkalojë ato me vullnetin e tij. Sipas këtij parimi, asnjë organ, në përbërje ose jo të një prej tre pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që sipas rastit do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve ose institucioneve të tjera kushtetuese (*shih vendimet nr. 41, datë 16.5.2017; nr. 23, datë 24.4.2015; nr. 24, datë 9.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Me fjalë të tjera, kompetenca e ushtruar nga prokuroria dhe gjykata në rastin konkret rrjedhin nga kompetenca kushtetuese e ushtrimit të ndjekjes penale dhe dhënies së drejtësisë që u është njohur atyre shprehimisht nga Kushtetuta dhe i përgjigjen qëllimit të pushtetit gjyqësor, ndaj është e palejueshme që një organ tjetër t'i anashkalojë ato me vullnetin e tij, siç duket se synohet të bëhet në rastin konkret.

12. Masa e sigurimit të ndalimit të ushtrimit të detyrës sipas nenit 242 të KPP-së është e përkohshme dhe i drejtohet individit e jo institucionit, ndaj nuk mund të barazohet me shkarkimin e ministrit (*as de facto*) dhe as me pezullimin administrativ, duke mos lindur kësisoj asnjë mosmarrëveshje kompetencash midis pushteteve. Zbatimi i saj nuk prek në vetvete kompetencat e pushtetit ekzekutiv, ndonëse ndalon përkohësisht individin deri në tre muaj (*neni 267 i KPP-së*) të ushtrojë detyrën e ministrit, me qëllim që të garantohet integriteti i procesit penal. Në ndryshim nga disa funksionarë të tjerë kushtetues (*si p.sh.: funksionarët e sistemit të drejtësisë që mund të pezullohen edhe vetëm për shkak të marrjes së cilësisë të pandehurit, pa qenë nevoja për marrjen e masës ndaluese sipas nenit 242 të KPP-së*), Kushtetuta vërtet nuk parashikon pezullimin administrativ të ministrit nga detyra, por kjo vjen për shkak se ky funksion është politik dhe në rastin e verifikimit të shkaqeve të pamundësisë së individit për ushtrimin e detyrës së ministrit (cilado qofshin ato), situata mund dhe duhet të zgjidhet me instrumentet politike përmes bashkëveprimit të organeve kushtetuese ose llogaridhënies në Kuvend, sipas neneve 77, 80 dhe 98 të Kushtetutës.

13. Për sa më lart, jemi të mendimit se kërkesa ishte haptazi e pabazuar që në krye të herës dhe rrjedhimisht nuk duhej të ishte kaluar për gjykim nga Gjykata në fazën e shqyrtimit paraprak të saj.

Anëtarë: Asim Vokshi, Marsida Xhaferllari.